

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“NDIKIMI I KORRUPSIONIT DHE HAPJES EKONOMIKE NË RITJEN EKONOMIKE
NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR”**

KANDIDATI:
Fatime Rushiti

MENTOR:
Doc.Dr.Besnik Fetai

Tetovë, 2020

Mirënjohje

Ky punim i tezës së masterit nuk do ishte përfunduar në qoftë se pranë meje nuk do të kisha disa njerëz të rëndësishëm me ndihmën e të cilëve arrita t'a përfundoj me sukses këtë punim. Për këtë jam falenderuese dhe shumë mirënjohëse. Përpjekjet, angazhimi dhe energjia e tyre e sinkronizuar me vullnetin dhe punën time e dha një fryt me të cilin do të ndjehem krenare. Në mënyrë të veçantë dëshiroj të shpreh mirënjohjen më të sinqertë ndaj mentorit, Doc.Dr. Besnik Fetaj, i cili pa kursyer asgjë më dha përkrahje profesionale dhe morale. Krahas këtyre më ka dhënë vërejtjet e duhura, udhëzimet dhe rekomandimet e tij më të sinqerta përgjatë gjithë punës sime, me qëllim që ky studim të jetë i suksesshëm. Këto që po i them nuk mund t'a përshkruajnë me fjalë mirënjohjen që e kam ndaj mentorit tim dhe që jam krenare dhe me fat që m'u dha rasti të punoj dhe të bashkëpunojë me një profesor të tillë me merita të mëdha.

Po ashtu, shpreh falenderime dhe mirënjohje të sinqerta për anëtarët e komisionit, për bashkëpunimin dhe durimin e treguar përgjatë periudhës së realizimit të këtij studimi.

Nuk do të ishte e mundur asgjë prej kësaj pune në qoftë se pranë meje nuk do të ishte familja ime e shtrenjtë, e cila nuk kurseu asgjë deri më sot e veçanërisht i falenderoj shumë që më mbështetën, më duruan dhe më besuan gjatë gjithë kohës.

Abstrakt

Arsyeja kryesore e këtij hulumtimi është pikërisht analiza e fenomenit shumë të përhapur fatkeqësisht që shkatërron ekonominë e një vendi i cili njihet si korrupsion. Si një problem universal, korrupsioni kërkon që jo vetëm të analizohet, por edhe të reagohet ndaj tij në mënyrë që të parandalohet dhe kjo të çojë në një ekonomi të pastërt dhe jo të korruptuar.

Duke iu referuar asaj se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kaluar nga komunizëm në kapitalizëm dhe demokraci, kanë hasur në vështirësi gjatë transformimit në ekonominë e tregut me çka ka pasuar liberalizimi i çmimeve, privatizimi, por gjithsesi nuk ka munguar korrupsioni si pengesë për zhvillimin ekonomik dhe si faktor për rënien ekonomike dhe rritjen e papunësisë.

Gjatë hulumtimit kam analizuar thellësisht aspektin e korrupsionit, rritjes ekonomike, hapjes ekonomike dhe papunësisë duke i vënë theks të veçantë raportit mes tyre.

Përmes këtij hulumtimi, është analizuar ndikimi i korrupsionit, papunësisë në rritjen ekonomike duke shqyrtuar raportin e zhdrejtë mes tyre dhe po ashtu janë analizuar efektet e hapjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, në veçanti rastin e vendeve si Maqedonia, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina dhe Serbia.

Për të krahasuar dhe testuar hipotezat e ngritura në këtë punim, janë përdorur modele dhe metoda të ndryshme ekonometrike me qëllim që rezultatet të jenë signifikante, siç janë modeli Random Effect, modeli Fixed Effect, modeli Pooled OLS dhe modeli i Hausman Taylor-it IV. Po ashtu do të përdoret metoda krahasuese për të bërë vlerësimin dhe dallimin në mes modeleve të lartpërmendura.

Rezultatet e arritura tregojnë një lidhje negative midis korrupsionit dhe rritjes ekonomike, po ashtu edhe lidhje negative midis korrupsionit dhe hapjes ekonomike, por nga ana tjetër një lidhje pozitive midis hapjes dhe rritjes ekonomike, gjë që tregon dëmet që sjell korrupsioni dhe efektet pozitive të hapjes ekonomike, veçanërisht për vendet në tranzicion.

Fjalët kyçe: Korrupsioni, Papunësia, Rritja Ekonomike, Hapja Ekonomike

Abstract

The main reason for this research is precisely the analysis of the unfortunately widespread phenomenon that destroys the economy of a country which is known as corruption. As a universal problem, corruption requires not only to be analyzed, but also to react to it in order to prevent it and lead to a clean and non-corrupt economy. Referring to the fact that the countries of the Western Balkans have moved from communism to capitalism and democracy, they have encountered difficulties in transforming into a market economy that has resulted in price liberalization, privatization, but nevertheless corruption has not been a hindrance to economic development and as a factor for the economic downturn and rising unemployment. During the research I have deeply analyzed the aspects of corruption, economic growth, economic openness and unemployment, with particular emphasis on the relationship between them.

This research analyzes the impact of corruption, unemployment on economic growth by examining the indirect relationship between them and also analyzes the effects of economic openness in the Western Balkan countries, in particular the case of countries such as Macedonia, Albania, Croatia, Montenegro, Bosnia and Herzegovina and Serbia.

To compare and test the hypotheses raised in this research, various econometric models and methods have been used to make the results significant, such as the Random Effect Model, Fixed Effect Model, Pooled OLS Model and Hausman Taylor Model IV. A comparative method will also be used to evaluate and distinguish between the aforementioned models.

The results show a negative relationship between corruption and economic growth, as well as a negative relationship between corruption and economic openness, but on the other hand a positive relationship between openness and economic growth, which shows the damage that corruption brings and the positive effects of economic openness, especially for transition countries.

Keywords: Corruption, Unemployment, Economic Growth, Economic Openness

Lista e figurave

Figura 1. Rritja reale e GDP-së në Ballkanin Perëndimor

Figura 2. Korrupsioni në vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 4. Mesatarja e hapjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Lista e tabelave

Tabela 1. Rritja reale e GDP-së në Ballkanin Perëndimor (% GDP)

Tabela 2. Korrupsioni në vendet e Ballkanit Perëndimor periudha 2008-2017

Tabela 3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor (%)

Tabela 4. Testimi i determinanteve të rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Tabela A1. Vendet e përfshira në modelin empirik.

Tabela A2: Përshkrimi i Variablave

Përmbajtja

Mirënjohje

Abstrakti

Abstrakt

Lista e figurave

Lista e tabelave

1. HYRJE	9
• Qëllimi	
• Pytjet hulumtuese	
• Hipotezat	
• Metodologjia	
2. RITJA EKONOMIKE	13
2.1. Rritja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor	13
2.2. Korrupsioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike	17
2.3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor	21
2.4. Hapja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor	23
2.4.1. Determinantet e Hapjes Ekonomike	25
2.4.2. Efektet pozitive të Hapjes Ekonomike	27
2.4.3. Efektet negative të Hapjes Ekonomike	28
3. RISHIKIMI I LITERATURËS	29
3.1. Aspekti teorik	29
3.1.1. Teoria Neoklasike	30
3.1.2. Teoria Neokenzijane	31
3.2. Evidence empirike	32
4. METODOLOGJIA	35
4.1. Modeli Pooled OLS	36
4.2. Modeli Fixed Effects	37
4.3. Modeli Random Effects	38

4.4.	Modeli Hausman Taylor-IV	39
4.5.	Zgjedhja në mes Fixed Effects dhe Random Effects duke e përdorur Hausman Test-in	40
4.6.	Vlerësimi i modeleve	40
5.	INTERPRETIMI I REZULTATEVE	41
	KONKLUSIONE	43
	REKOMANDIME	45
	REFERENCAT	48
	APPENDIX. A	51
	APPENDIX. B	52

1. HYRJE

Korrupsioni ka një impakt të rëndësishëm ekonomik dhe social, e cila është rritur shumë sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor. Si pasojë e këtij ndikimi gjithnjë e në rritje shumë organizata kanë studiuar burimet e korrupsionit për të gjetur zgjidhjet më optimale për këtë fenomen p.sh, Banka Botërore e përkufizon korrupsionin si: 'Pengesën më të madhe për zhvillimin ekonomik dhe social'. Studimet e shumta teorike tregojnë që korrupsioni mund të sjellë dështime të qeverisë dhe të nxisë rritjen ekonomike në periudhën afatshkurtër. Por, meqë dështimet e qeverisë vinë si pasojë e korrupsionit, atëherë korrupsioni ka efekte të rëndësishme në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë. Megjithatë, korrupsioni është një sjellje devijuese e ushtrimit të një detyre publike nga ajo normale, me qëllim të përfitimit personal.

Me fjalë të tjera me korrupsion nënkuptojmë shkeljen e rregullave juridike me qëllim të përfitimit personal. Kjo situatë thekson problemin dhe nevojën për analiza të mëtutjeshme të korrupsionit në rritjen ekonomike. Anadaj ne do të parashtrojmë pyetjen hulumtuese se korupsioni do të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike? Po ashtu edhe dy hipotezat e tjera të ngritura kanë të bëjnë me ndikimin e papunësisë dhe të hapjes ekonomike në rritjen ekonomike.

Papunësia është një nga dukuritë më të mundimshme dhe aktuale, e pranishme në mbarë botën por me theks të veçantë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, në vendin tonë, pasojat e papunësisë mbeten vetëm në nivelin e përjetimeve personale e familjare edhe pse ato shtrihen në shumë nivele të shoqërisë duke u bërë shpesh herë shkak i shumë dukurive devijuese. Por, ky fenomen më tepër duhet të shihet si problem social i tërë shoqërisë dhe duhet të merret seriozisht qeveria me këtë fenomen me qëllim që shkalla e papunësisë të ulet që të rritet mirëqenia.

Shumë shoqëri studiojnë pasojat e papunësisë dhe hartojnë terapi individuale dhe grupore për tejkalimin e tyre duke e konsideruar atë si një çështje e gjithë shoqërisë. Ajo që dihet është se shteti si organizuesi mbarëshoqëror i cili përmes institucioneve sociale merret me studimin e kërkesave

për punë, me karakteristikat e çdo individi, pra krijimin e një baze të saktë të dhënash dhe informimin e vazhdueshëm të subjekteve për t'u punësuar. Ndërkohë këto struktura sociale, hyjnë në studimin edhe të dukurive të tjera sociale duke u shndërruar në amortizatorë të tyre. Shkalla e papunësisë është një tregues i mirëqenies ekonomike dhe sociale në përgjithësi. Një shkallë e ulët e saj është tregues i një ekonomie të fortë ku ata që kërkojnë punë mund t'a gjejnë shpejtë atë, ndërsa një shkallë e lartë e papunësisë tregon për një ekonomi të dobët. Për këto tregues dhe më tepër kemi diskutuar dhe hulumtuar që të japim rezultate më të freskëta në lidhje me papunësinë në vendet në tranzicion siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Siç e cekëm më lartë që një nga objektivat tona është që të hulumtojmë hapjen ekonomike në vend dhe në rajon, ne do të japim një pasqyrë të përgjithshme mbi hapjen ekonomike duke theksuar përparësitë që sjell hapja ekonomike veçanërisht për vendet që janë në zhvillim e cila sjell rritje të produktivitetit dhe të prodhimit në përgjithësi, por do t'i përmendim edhe efektet negative që sjell hapja ekonomike. Hapja ekonomike e njohur si liberalizimi i tregtisë- është kusht jetik për krijimin e një pozite të favorshme në tregjet ndërkombëtare. Ajo është një nga mënyrat më të shpeshta dhe të lehta për rritjen ekonomike të një vendi duke lejuar një tregti të lirë dhe të mirëfilltë ekonomike.

Për këto çështje dhe më shumë, kam përdorur modele dhe metoda të ndryshme ekonometrike, tregues ekonomik, specifikime të ndryshme të modeleve si dhe grup të dhënash në përpjekje për të arritur në shpjegime që do të ishin të pranueshme ndërkombëtarisht. Hulumtimet kryesisht trajtojnë njëri nga hipotezat e ngritura në këtë hulumtim shkencor, që është ndikimi negativ i korrupsionit në rritjen ekonomike duke arritur të spjegoj arsyet e përhapjes së korrupsionit dhe pasojat e mëdha direkt mbi ekonominë e një vendi. Hulumtimi im përfshinë disa vende të Ballkanit Perëndimor siç janë: Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Kroacia, Bosna dhe Hercegovina dhe Shqipëria.

Testimi i hipotezave përmes modeleve dhe sqarimeve efikase dhe produktive se me rritjen e korrupsionit ndikohet negativisht në rritjen ekonomike, do të përpiqet të jep një pasqyrë të përgjithshme për fenomenin në fjalë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përveç korrupsionit kemi caktuar edhe dy hipoteza të tjera që po ashtu kanë të bëjnë me faktorët që ndikojnë

pozitivisht dhe negativisht mbi rritjen ekonomike dhe të cilat janë ‘papunësia’ dhe ‘hapja ekonomike’. Në bazë të kësaj, do t’i trajtoj institucionet shtetërore dhe bizneset private në Ballkanin Perëndimor si dhe institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore që trajtojnë korrupsionin dhe format e tjera të krimit si barrier e madhe për rritjen ekonomike të një vendi madje edhe si shkatërrim të demokracisë në nivel global. Qëllimi im në këtë hulumtim është që të përdor teknikë vlerësimi të besueshme dhe të aplikuar nga autorë të shumtë me çka përmes modeleve dhe teknikave të “Panel Data”, gje gjësisht “Random Effects”, “Fixed Effects” dhe Hausman Taylor-IV, për të testuar dhe vlerësuar raportin dhe lidhjen mes rritjes ekonomike, hapjes ekonomike, korrupsionit, në vendet e Ballkanit Perëndimor të numëruara më lartë. Gjatë hulumtimit do të bazohem në të dhëna sa më të freskëta që arrijnë deri në vitin 2017.

H1\3 Korrupsioni ndikon negativisht në rritjen ekonomike

H2\3 Papunësia ndikon negativisht në rritjen ekonomike

H3\3 Hapja ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike

Pas përcaktimit të hipotezave të parashtruara në këtë hulumtim, struktura e punimit është si në vijim: Në kreun e dytë kam analizuar faktorin “korrupsion” dhe ndikimin e tij në rritjen dhe hapjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në mënyrë analitike kam analizuar rritjen ekonomike për vendet që i kemi target në këtë hulumtim, konceptin e korrupsionit, ndikimin e tij mbi rritjen dhe hapjen ekonomike ku është përdorur metoda narrative duke i ilustruar në formë grafike raportet e këtyre variablave dhe konstatimeve që unë kam bërë në fillim të këtij hulumtimi shkencor që studion korrupsionin, rritjen dhe hapjen ekonomike në vendet në tranzicion të Ballkanit Perëndimor. Në këtë hulumtim janë kombinuar metoda teorike dhe ajo empirike për grumbullimin e të dhënave në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të pastër rreth variablave në fjalë. Po ashtu fenomene tjera të trajtuara në këtë kapitull janë papunësia dhe inflacioni që poashtu janë target i hipotezave tona dhe kanë raport të zhdrejtë me rritjen ekonomike të cilën do t’a vërtetojmë përmes analizave në kreun e fundit.

Kapitulli i tretë përmbledh rishikimin e literaturës mbi ndikimin e korrupsionit dhe papunësisë në rritjen dhe hapjen ekonomike, raportin rritje-hapje ekonomike ku në mënyrë të veçantë kam

analizuar dhe përmbledhur aspektin teorik dhe evidencën empirike në lidhje me vërtetimin e hipotezave nga aspekti teorik. Në këtë pjesë kam analizuar mospajtimet dhe kundërshtimet nga studiues të ndryshëm duke i potencuar edhe kritikën e adresuar për çështjet e hulumtuara me qëllim që ky punim t'i përfshijë të gjitha anët e mundshme për sqarimin e fenomeneve të lartëpërmendura. Evidenca empirike e ndikimit të variablave që kanë impakt pozitiv në rritjen ekonomike, është ngushtë e lidhur me pjesën teorike pasi që kjo pjesë bën testimin e hipotezave nga aspekti ekonometrik. Po ashtu, në mënyrë të veçantë kam analizuar dhe shqyrtuar metodologjinë dhe modelet e përdorura nga shumë autorë në punimet e tyre shkencore. Është përdorur literaturë ndërkombëtare me qëllim që edhe hulumtimi të merr dimension ndërkombëtar. Kapitulli i katërt është i rezervuar për metodat dhe modelet e përdorura që në mënyrë shkencore të vlerësohet rëndësia e ndikimit të variablave në modelin e ndikimit të korrupsionit në rritjen dhe hapjen ekonomike.

Duke sqaruar teknikën "Panel Data" dhe duke realizuar modelet e tjera ekonometrike për testimin e hipotezave, gjegjësisht variablave të këtij hulumtimi të cilat kanë ndikim të lartë në rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këto modele janë përpiluar dhe analizuar me qëllim të vlerësimit sa më të saktë të variablave të trajtuara. Kreu i pestë përfshinë interpretimin e rezultateve të hulumtimit me të cilat i kemi hedhur ose i kemi pranuar hipotezat e parashtruara. Pas kësaj, në fund i kemi dhënë përfundimet dhe rekomandimet që mendojmë se janë të dobishme. Besoj se ky punim do të ketë rëndësi shkencore për të treguar dhe për të dhënë pasqyrë të qartë rreth faktorëve dhe variablave që ndikojnë në rritjen ekonomike, gjegjësisht për të treguar efektin e korrupsionit mbi rritjen dhe hapjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Struktura e këtij punimi është bazuar në një renditje adekuate të titujve sipas rëndësisë së tyre për shtjellim, me qëllim që të jetë më i kuptueshëm dhe më i qartë për analizim.

2. RITJA EKONOMIKE

Qeveritë në mbarë botën merren me rritjen ekonomike si masë për performancën e vendeve në terma absolut, ose thënë ndryshe sa shpejtë jemi duke u rritur, dhe nga ana tjetër në terma relativ-a jemi duke u rritur me shpejtësi sa fqinjët tanë? Rritja ekonomike në të shumtën e rasteve kuptohet si pasqyrim i rritjes së standardit të jetesës me kalimin e kohës (Hanley, Shogren & White, 2001). Andaj, kur flasim për rritjen ekonomike, e kemi parasysh faktin se nga ajo varet edhe stabiliteti ekonomik dhe njëkohësisht edhe standardi i jetesës së një shoqërie apo një vendi. Pra, norma e rritjes së ekonomisë është një matës i rëndësishëm i ekonomisë së një vendi. Kur një ekonomi nuk arrinë të rritet, thuhet se është stagnuar. Stagnimi mund të jetë problem serioz sepse standardi i jetesës nuk po rritet dhe kjo mund të krijojë stres të rëndësishëm social dhe politik. Prodhimi Bruto i Brendshëm paraqet matësin kryesor të sigurimit ekonomik të mallrave dhe shërbimeve. Pra, ai përfshinë të gjitha të mirat dhe shërbimet përfundimtare të prodhuara në një vend. Me fjalë të tjera, në qoftë se do duheshite të zgjedhet një masë që tregon performancën ekonomike të një vendi, pa dyshim që ekonomistët do të zgjedhnin Bruto Prodhimin e Brendshëm (Walton, Wykoff, 1989).

2.1. RITJA EKONOMIKE NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

Është e njohur tash më se të gjitha ekonomitë e tranzicionit përballen me problem të ngjajshëm në fillim të tranzicionit, por jo të gjitha menaxhojnë në mënyrë të duhur dhe të shpejtë adaptimin në mjedisin e ri ekonomik dhe jot ë gjithë arrinë të përmirësojnë performancën makroekonomike. Në vitet e hershme të tranzicionit, të gjitha ekonomitë e tranzicionit përjetuan një rënie të mprehtë të prodhimit, të shoqëruar nga rënia e prodhimit industrial dhe nga investimet (EBRD, 1999). Problemet që u paraqitën në shumicën e vendeve në tranzicion ishin rritja rapide e inflacionit dhe rritja e shkallës së papunësisë. Arsyeja e rritjes së inflacionit ishte si rezultat i liberalizimit të shpejtë të çmimeve dhe rezultat i politikës monetare inflacioniste. Kjo ka çuar që të ardhurat e pamjaftueshme t'i detyronin vendet të adoptojnë financimin monetar të buxhetit (Natalja von Westernhagen, 2002).

Maqedonia e Veriut ka pasur një rënie të mprehtë të ekonomisë gjatë periudhës 1991-1993 për shkak të nivelit të lartë të inflacionit dhe borxhit të cilin e ka trashëguar nga

Jugosllavia. Ajo gjatë dy dekadave të para të periudhës së tranzicionit, në mesatare ka pasur shkallën më të ulët të rritjes së GDP në rajon (Kota, 2009).

Po ashtu, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë implementuar reforma të rëndësishme për rritjen apo zhvillimin ekonomik pas vitit 2000, por jo të gjitha vendet kanë patur shpejtësi të njejtë të zhvillimit ekonomik. Kështu, në Maqedoninë e Veriut i ashtuquajtimi procesi catching-up¹ ka filluar pas vitit 2001, me nënshkrimin e Programit për Stabilizim-Asocim me BE-në. Ky trend i rritjes ekonomike do të ndalet gjatë krizës financiare në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, nga e cila filloi trendi negativ i rritjes ekonomike. Kjo nuk ndodhi në Shqipëri e cila kishte reduktuar në mënyrë të duhur procesin e rritjes ekonomike. Krahas vendeve të tjera që kanë shkuar përmes një procesi të ristrukturimit si në planin makroekonomik ashtu edhe atij mikroekonomik, Serbia aplikoi politika në mënyrë që ekonomia të jetë e strukturuar ashtu që t'iu përgjigjet kërkesës dhe ofertës së tregut. Kështu në periudhën pas shpërbërjes së Jugosllavisë, në Serbi nuk kishin ndodhur ndryshime të rëndësishme. Të ardhurat nuk u grumbullonin nga investimet e huaja direkte, por më shumë ishin nga procesi i privatizimit i cili kishte filluar të përhapej shumë shpejtë. Perëndimi përmes sanksioneve që i kishte vendosur arriti të ndikojë në rënien e Bruto Prodhimit të Brendshëm në dekadën e parë të tranzicionit. Rritja më e lartë e tregut ishte gjatë vitit 2002 dhe 2003. Mirëpo, në Sërbi vazhdoi niveli i ulët i investimeve publike, të cilat nuk u rritën më të njejtin nivel të shpenzimeve. Por, pas përfundimit të luftës civile, Serbia arriti të rrit me shpejtësi GDP-në, por për shkak të mungesës së kapaciteteve të mobilizimit të burimeve të brendshme të rritjes, ritmet e rritjes u ngadalësuan në 5 %. Rritja e prodhimit vendas, pas vitit 2003, ka inicuar një rritje të GDP-së por njëherit me ulje ngritje përgjatë periudhave. Për shkak të nivelit të lartë të borxhit dhe inflacionit që ka trashëguar nga Jugosllavia, Maqedonia e Veriut pati një rënie të mprehtë të ekonomisë gjatë periudhës 1991-1993. Program i stabilizimit i cili u zhvillua në vitin 1994 kishte ndikuar në rritjen ekonomike. Pastaj, kriza e vitit 2001 shkaktoi një rënie të thellë të GDP-së. Maqedonia e Veriut gjatë dy dekadave të para të periudhës së tranzicionit në mesatare ka

¹ The Republic of Macedonia, the first country from the West Balkan's region that in April 2001 signed the Stabilization and Association Agreement (SAA) with the European Union, which entered into force on 1 April 2004. The Republic of Macedonia applied for EU membership.

pasur gati se shkallën më të ulët të rritjes së GDP-së në rajon (Zuzana Murgasova, Nedeem Ilahi, Jacques Miniane, Alasdair Scott, Ivanna Vladkova-Hollar and IMF Staff Team, 2017).

Tabela 1. Rritja reale e GDP-së në Ballkanin Perëndimor (përqindje):


Vitet	Serbia	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Kroacia	Bosna	Shqipëria
1997	8.97					
1998						
1999	14			0.77		
2000	9.78		10.04	0.6		10.95
2001	-9.64		4.73	2.28		1.79
2002	13.41		3.59	3.24		-10.88
2003	10.8		-2.19	3.65		5.68
2004	7.99		6.75	-5.12		5.48
2005	7.87		3.33	0.4	1.77	4.17
2006	3.33		4.88	2.5	2.31	2.94
2007	6.32	4.81	5.37	4.38	4.19	9.56
2008	6.57	4.05	4.15	4.14	4.01	5.72
2009	6.27	6.35	4.21	4.84	8.42	4.01
2010	5.87	5.19	4.98	6.01	10.53	5.83
2011	6.88	6.33	5.15	4.84	6.75	4.24
2012	8.75	7.02	2.12	-1.2	-5.82	-3.12
2013	4.31	5.62	-6.83	2.82	2.39	1.41
2014	4.5	-2.71	-2.02	2.72	3.14	2.37
2015	4	0.9	2.96	-0.48	-2.57	-1.04
2016	5.2	1.2	2.87	1.2	3.12	1.2
2017	5.1	1.06	3.15	2.3	3.17	1.9

Burimi: IMF's IFS - via The World Bank

Siç mund të shihet se Maqedonia e Veriut rritjen më të madhe e ka pasur në vitin 2000 me 10.4%, ndërsa pas kësaj periudhe ka pasur lëkundje në rritjen e GDP dhe nivelin më të ulët e ka patur në vitin 2014 me -2.02%. Po ashtu Shqipëria ka hasur ulje ngritje gjatë kësaj periudhe, kështu që në vitin 2000 ka patur nivel më të lartë të GDP-së me 10.95% ndërsa niveli më i ulët për Shqipërinë regjistrohet në vitin 2012 më -3.12% rritje të GDP-së. Bosna dhe Hercegovina në vitin 2010 e kanë patur rritjen më të madhe të GDP-së me 10.53%. Mali i Zi vazhdimisht ka pasur nivele të ulëta të rritjes ekonomike, madje në vitin 2017 është arritur një rritje tepër e

vogël me 1.06 %. Në Sërbi nga viti 2002 e këndej gjithmonë rritja e GDP-së ka qenë me ulje të vazhdueshme. Kroacia vitet e fundit është përballur me një rritje të vogël të GDP-së.

Grafikoni 1. . Rritja reale e GDP-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Kalkulime nga autori

Sugjerimet që vinë nga ana e Bankës Botërore këshillojnë që Maqedonia e Veriut të ndjekë agjendë ambicioze të reformave strukturore për të shpejtuar rritjen e produktivitetit dhe konvergencës së të ardhurave, me mundësinë e hapjes së bisedimeve për pranim në Bashkimin Europian, për këtë deklaroi Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Ndër të tjerat, Fondi poashtu u bëri thirrje autoriteteve maqedonase të përmirësojnë cilësinë e arsimit të mesëm dhe profesional dhe të riformojnë arsimin terciar në drejtim të dhënies së aftësive të kërkuara nga ekonomia për të reduktuar mungesat dhe mospërputhjet e aftësive.²

² Western Balkans Regular Economic Report No. 14.

2.2. Korrupsioni dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike

Korrupsioni si fenomen ka qenë prezent qysh në kohëra të hershme të njerëzimit dhe po ashtu do të vazhdojë edhe në periudhat e ardhshme deri sa qeveria do të mund të gjejë forma efikase për t'a ndaluar atë. Sigurisht që ndikimi dhe pasojat e korrupsionit kanë një histori në vete për ekonominë. Megjithatë, kjo mënyrë nuk do të jetë aspak e përballeshme dhe e lehtë për një shoqëri në tranzicion. Vendet e zhvilluara ekonomikisht kanë arritur në një mënyrë që t'a kontrollojnë nivelin e korrupsionit, por pjesa më e madhe dhe e ndijshme janë vendet në tranzicion ose që janë të pazhvilluar ose në zhvillim. Në këtë këndvështrim duket qart se niveli i korrupsionit ka qenë i pranishëm në të gjitha vendete e botës. Po ashtu deri më sot, asnjë sistem qeveritar dhe administratë nuk ka mundur të mbrohet prej korrupsionit që prej kohërave shumë ta lashta. Ky fenomen ende vazhdon të ekzistojë si një prej formave më të përhapura dhe më të mprehta që shkatërron themelet e administratës shtetërore.

Megjithatë, korrupsioni është një nga alternativat më fatale ndër të cilat më të prekura janë vendet e Ballkanit Perindimor. Efektet negative të tij janë të pranishme në të gjitha sferat e jetës sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Është e ditur që korrupsioni ka shumë kosto dhe është shumë i vështirë për t'u menaxhuar dhe kontrolluar. Në vend të konkurrencës në cilësi dhe të asaj në të mira dhe shërbime, ai nxit dhe stimulon konkurrencën në rryshfete. I njejtë pengon zhvillimin e një tregu normal. Mbi të gjitha ai frenon zhvillimin ekonomik dhe social, duke dëmtuar sidomos vendet në zhvillim ku bëjmë pjesë dhe ne dhe vendet tjera që kemi në hulumtim. Në raste të tilla, më të dëmtuarit janë të varfërit të cilët përveç se duhet të paguajnë kostot e tyre, ato po ashtu duhet të paguajnë jo vetëm për korrupsionin e zyrtarëve të tyre, por edhe të atyre të kompanive nga vendet e zhvilluara. Sipas studimeve të bëra dhe statistikave, dëmet që sjell korrupsioni janë të mëdha ngase ai rrit koston e të mirave dhe shërbimeve, sjell investime të panevojshme, si dhe ul cilësinë e shërbimeve të infrastrukturës. Të dhënat e fundit mbi korrupsionin, tregojnë se përhapja e tij nuk është problem vetëm i vendeve në zhvillim, por dhe i vendeve të zhvilluara të cilat në mënyrë të pashmangshme duhet të përballen me korrupsionin. Vendet e zhvilluara luajnë një rol të madh si dhënës i rryshfeteve në transaksionet e biznesit ndërkombëtar dhe janë të prekura edhe nga korrupsioni i brendshëm kryesisht ai

politik. Për shkak të korrupsionit të burokratëve, shumë ndërmarrje detyrohen të kalojnë në ilegalitet. Nga ana tjetër, për shkak të fitimeve të mëdha që sjell rryshfeti dhe rreziqeve të vogla që e shoqërojnë atë, i detyrojnë talentët të punësohen në administratën publike në vend që të merren me veprimtari krijuese, sepse e kanë më të lehtë punësimin në administratë. Në të njejtën kohë, korrupsioni i policisë dhe i organeve të drejtësisë ndikon negativisht ndaj besimit të qytetarëve në lidhje me sistemin ligjor dhe kjo çon që të mendohet dhe të zgjedhen rrugët tjera alternative në bazë të të cilave do të vendosin drejtësi, të cilat rrugë janë më të rënda dhe më të këqija, si për shembull: kanuni, hakmarrja, organizimi i bandave të ndryshme kriminale, etj. Kurse rastet e korrupsionit të personave me poste udhëheqëse si ato të ministrave, deputeteve, apo drejtorëve të ndryshëm rrënon legjitimitetin politik, pasojat e të cilit janë shkatërruese. Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve paguajnë rryshfete për publikun zyrtarë në vazhdimësi gjatë rrjedhës së vitit. Bizneset në sektorin e Ndërtimit janë ato më të prekura nga rryshfeti, pastaj renditen bizneset në tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë. Ndërkohë, aksionet më të mëdha të rryshfetit u paguhen zyrtarëve publikë në nivel lokal (zyrtarë komunalë ose provincialë) dhe zyrtarëve në administratën tatimore dhe doganore, gjë që tregon se rryshfeti mund të jetë një faktor i rëndësishëm në evazionin fiskal dhe kështu ushtron një ndikim negativ në financat publike. Afërsisht një në dhjetë biznese (10.2 përqind) që kanë pasur kontakt me një zyrtar publik në 12 muajt para anketimit kanë paguar rryshfet një zyrtar publik. Kjo do të thotë se, edhe pse ekzistojnë ndryshime të rëndësishme midis vendeve në të gjithë rajonin, prevalenca mesatare e rryshfetit të biznesit në Ballkanin Perëndimor është shumë afër përqindjes së qytetarëve të zakonshëm të Ballkanit Perëndimor (12.5 përqind) sipas anketës së përgjithshme të popullsisë së UNODC-it për vitin 2011.³ Mbi një e treta (35.7 përqind) e të gjitha rryshfeteve që u paguhen zyrtarëve publik nga bizneset në Ballkanin perëndimor paguhen me para në dorë, me një mesatare prej 880 EUR-PPP për rryshfet. Pagesa e parave është veçanërisht e rëndësishme në Ndërtimin (43.3 përqind) dhe Transportin dhe Sektorët e ruajtjes (45.5 përqind), ku ajo përbën pothuajse gjysmën e të gjitha pagesave të rryshfetit. Për të eliminuar korrupsionin dhe format e tjera të krimit, është e nevojshme vendosja e masave më të mira për mbrojtjen e bizneseve kundër krimeve, si dhe për

³ Data referring to bribery by individuals and households are taken from the recent UNODC study, Corruption in the Western Balkans: bribery as experienced by the population (2011).

parandalimin e korrupsionit dhe këto masa mund të jenë me ndikim shumë të madh dhe pozitiv mbi korrupsionin. Pra, për shkak të korrupsioni të biznesit, gjithmonë do të ketë pengesë për tregtinë, investimet dhe zhvillimin ekonomik⁴.

Tabela 2. Korrupsion në vendet e Ballkanit Perëndimor (në përqindje)

Vitet	Shqipëria	Serbia	Mali Zi	Kroacia	Maqedonia e Veriut	Bosnje.H
2008	3.4	3.4	3.4	4.4	3.6	3.2
2009	3.2	3.5	3.9	4.1	3.8	3
2010	3.3	3.5	3.7	4.1	4.1	3.2
2011	3.1	3.3	4	4	3.9	3.2
2012	3.3	3.9	4.1	4.6	4.3	4.2
2013	3.1	4.2	4.4	4.8	4.4	4.2
2014	3.3	4.1	4.2	4.8	4.5	3.9
2015	3.6	4	4.4	5.1	4.2	3.8
2016	3.9	4.2	4.5	4.9	3.7	3.9
2017	3.8	3.9	4.6	4.9	3.5	3.8

Burimi: /www.transparency.org/cpi2017


Siç mund të shihet nga tabela, vendet e rajonit janë diku afër sipas nivelit të korrupsionit, edhe atë Maqedonia e Veriut nga një nivel prej 3.6 % në vitin 2008, me ulje ngritje arrinë që në vitin 2014 të regjistrojë një nivel të lartë të korrupsionit edhe atë me 4.5%, ndërsa pastaj pëson rënie dhe në vitin 2017 arrinë nivelin e korrupsionit 3.5 %. Ulje ngritje të ngjashme kanë pasur edhe Kroacia e cila ka patur një nivel të lartë të korrupsionit në vitin 2008 me një shkallë të lartë prej 4.4%, ndërsa në vitin 2017 me 4.1 %. Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi në vitin 2008 kanë patur nivel të njëjtë të shkallës së korrupsionit edhe atë 3.4 %, dhe po ashtu edhe gjatë vitit 2017 kanë regjistruar nivel të ngjashëm, por Mali i Zi ka arritur shkallë të lartë të korrupsionit me 4.6 %. Për afërsisht e njëjta gjë përsëritet edhe me Bosnën dhe Hercegovinën e cila në vitin 2008 ka patur 3.2 % shkallë të korrupsionit, ndërsa në 2017 shkalla e korrupsionit arrinë 3.8 %. Korrupsionit i shpallur në Transparency International, zbulon se mospasuria i

⁴ UNODC (United Nations Office on Drugs and Crime), Business, Corruption and Crime in the Western Balkans, 2013, fq. 8-9.

vazhdueshëm i më shumë shteteve në kontrollimin e korrupsionit sjell krizën e demokracisë në botë.⁵

Marrja e parave, dhuratave ose favoreve tjera në mënyrë të jashtëligjshme për përfitime personale të nëpunësve civil, paraqet një akt të korrupsionit publik, përveç tarifës së nevojshme zyrtare. Në sektorin publik në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ndërveprimi i drejtpërdrejtë në mes një përfaqësuesi të një biznesi dhe një zyrtari publik, është i nevojshëm për të kryer një akt të rryshfetit, për të marrë një favor ose lehtësim nga ana e institucioneve publike. Pra, përhapja e korrupsionit llogaritet në atë mënyrë se si bizneset japin para ose dhurata për zyrtarët e institucioneve publike. Kështu, përhapja mesatare e korrupsionit të bizneseve në rajonin e Ballkanit Perëndimor është 10.2 %, që do të thotë se rreth një në dhjetë biznese kanë paguar rryshfet një zyrtari publik⁶.

Grafikoni 2. Korrupsion në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Kalkulim nga autori

Përqindje relativisht të larta të nivelit të korrupsionit janë regjistruar në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përgjatë periudhave, madje shkalla e përqindjes në vendet e rajonit është shumë e përafërt me njëra-tjetrën, gjë që tregon se korrupsioni është i pranishëm gjithandej, madje edhe shumë dominant.

⁵ /www.transparency.org/cpi2017

⁶ UNODC (United Nations Office on Drugs and Crime), Business, Corruption and Crime in the Western Balkans, 2003, fq. 14-15.

2.3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor

Papunësia si një sëmundje e rëndë është shumë e studiuar dhe e hulumtuar për shkak që të definohen arsyet që e shkaktojnë atë. Si një fenomen që shkatëron ekonominë e një vendi, ajo vjen nga disa arsye. *Së pari*, është papunësia e fërkimit. Kjo nënkupton që tregjet nuk punojnë menjëherë. Pra, ka nga ata njerëz që nuk marrin një punë tjetër pasi të kenë lëshuar punën paraprake. Ndërkohë ata kërkojnë përfitime si njerëz të papunë. *Së dyti* është papunësia sezonale. Kjo nënkupton atë që ka disa njerëz që janë të punësuar vetëm gjatë sezoneve si për shembull, disa njerëz gjejnë punë në verë në fushën e turizmit, por janë të papunë në muajt e dimrit. Një pjesë e atyre të punësuar në industrinë e ndërtimit janë jashtë punës nëse koha është e rëndë në dimër. *Së treti* është papunësia strukturore. Kjo ka të bëjë me atë se nëse kërkesa për prodhim e një industrie bie me shpejtësi, inputet e punës nuk kërkohen shumë. *Së katërti* është papunësia vullnetare. Kjo po ashtu nënkupton që ekzistojnë njerëz të papunë ngase nuk duan të punojnë me normën e pagave që iu ofrohet, por preferojnë të mos bëjnë asgjë dhe të jetojnë nga përfitimet e shtetit. *Së pesti* është kërkesa deficitare e papunësisë. Me këtë nënkuptojmë që njerëzit mund të jenë të papunë sepse vëllimi i kërkesës për mallra dhe shërbime në tërë ekonominë, atë që ne e njohim si kërkesë agregate, nuk është mjaftueshëm e lartë për të gjithë ata që kërkojnë të gjejnë një punë. Është e rëndësishme të kuptohet se nuk është problem mungesa e kërkesës në një fushë të caktuar, por mungesa e kërkesës në ekonominë si tërësi (Ken Heather, 2000).

Llojet e papunësisë të përmendura më lartë, nuk nënkuptojnë zbutjen e konceptit të papunësisë edhe nëse papunësia do të ishte sezonale. Prapsepapë ajo është një lloj i papunësisë. Me këtë duhet të kemi të qartë se ndryshe nga inputet materiale dhe makinerike të procesit të prodhimit, fuqia punëtore nuk mund të mbahet në stoqe të inventarizuara dhe të ruhet për përdorim kur të fillojë përsëri kërkesa. Ajo nuk është input material apo makineri që të ruhet (Walton. Wykoff, 1998).

Sipas Bankës Botërore, e njëjta diagnozë vlenë për papunësia e cila shquhet si sëmundje e rëndë makroekonomike. Shpesh herë rritja e treguesit të papunësisë konsiderohet si një simptomë e fazës së recesionit ekonomik të një vendi. Nga aspekti ekonomik, një papunësi e lartë nënkupton një shmangie e bruto prodhimit të mbrendshëm, zvoglimi i të ardhurave në

familje apo shtimi i numrit të varfëis.⁷ Pasi që shfaqja e papunësisë në ekonomitë në tranzicion ka sfiduar disa pritshmëri, megjithatë, të gjitha vendet e shqyrtuara kanë përjetuar një “recesion transformues” edhe pse ato kanë ndryshuar në kohëzgjatje dhe në intensitet (Mickiewicz, Bell, 2013).

Tabela 3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor (në përqindje)

Tema	Indicator	Vendet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Njësia
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Shqipëria	14.04	13.98	13.35	15.93	17.49	17.09	15.22	13.75	në % të forces së punës, mesatares së peridhës
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Bosna dhe Hercegovina	27.21	27.58	28.01	27.49	27.52	27.69	25.41	20.53	në % të forces së punës, mesatares së peridhës
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Mali i Zi	19.67	19.7	19.72	19.5	18	17.54	17.72	16.07	në % të forces së punës, mesatares së peridhës
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Republika e Maqedonisë së Veriut	32.02	31.38	31.02	29	28.03	26.07	23.72	22.38	në % të forces së punës, mesatares së peridhës
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Serbia	19.5	23.25	24.22	22.45	19.2	17.66	15.25	13.47	në % të forces së punës, mesatares së peridhës
Tregu i punës	Shkalla e papunësisë	Kroacia	11.66	13.75	16.01	17.31	17.33	16.2	13.12	11.22	në % të forces së punës, mesatares së peridhës


Burimi: SEE Jobs Gateway Database

Një nivel i lartë i papunësisë ekziston në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor edhe atë siç shihet se nivelin më të lartë të papunësisë e ka Republika e Maqedonisë së Veriut e cila në vitin 2010 ka arritur nivelin e papunësisë në 32.02 %. Vitet në vazhdim ka patur luhatje por megjithatë është ndjekur me rënie niveli i papunësisë dhe kështu niveli më i ulët i papunësisë është regjistruar në vitin 2017 me 22.38 %. Nivele të larta të papunësisë ka pasur në të gjitha vendet e rajonit. Bosna dhe Hercegovina në vazhdimësi ka patur nivel të lartë të papunësisë dhe është lëkundur midis 27 dhe 28 %, por nivelin më të ulët e ka arritur në vitin 2017 me 20.53 % papunësi. Serbia në fillim nga viti 2010 ka patur rritje të papunësisë e cila ka lëvizur nga 19 % deri 24 %, por edhe Serbia në vitin 2017 ka regjistruar një rënie në 13.47 % të papunësisë. Ndër

⁷ Banka Botërore, Unemployment, total (% of total labor force), qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS>.

vendet me një normë të papunësisë më të ulët është Kroacia e cila vetëm në vitin 2013 dhe 2014 ka patur normën më të lartë të papunësisë me 17.31 %, gjegjësisht 17.33 %.

Grafikoni 3. Papunësia në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Kalkulim nga autori

Edhe pse korrupsioni dihet që ka ndikim negativ mbi ekonominë madje konsiderohet nga shumë analistë si një faktor pengues për proceset e ndërtimit të një ekonomie të qëndrueshme, qëllimi është që ky studim të analizojë ndikimin e rëndësishëm që ka korrupsioni apo rolin e tij në ekonomi, pasojat e korrupsionit në variablat kryesorë ekonomike dhe veçanërisht në rritjen ekonomike.


2.4. Hapja Ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Nga fakti se çdo ekonomi ka qëllim dhe synim kryesorë makroekonomik rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, vazhdimisht tentohet sa më shumë në liberalizimin e tregut. Avantazhet e secilës prej tyre janë shumë të dëshirueshme për një vend sepse përmes tyre rritet mirëqenia e vendeve, standardi i jetesës, rritet punësimin, rriten investimet dhe rritet fitimii i kompanive duke i bërë më konkurrese në tregun global. Një ekonomi e hapur është ajo ekonomi në të cilën ekzistojnë aktivitete midis lidhjeve vendas dhe jasht vendit. Kjo sqarohet me mënyrën që njerëzit dhe bizneset mund të tregtojnë mallra dhe shërbime me biznese tjera. Avantazhet që sjell një ekonomi e hapur janë të shumta si për

shembull një avantazh primar është se konsumatarët kanë një shumëllojshmëri të madhe të mallrave dhe shërbimeve nga të cilët janë në gjendje të zgjedhin atë që më tepër ju konvenon. Po ashtu një avantazh i rëndësishëm është se nëse një vend ka ekonomi të hapur, ai vend në çdo vit nuk ka nevojë të barazojë prodhimet e mallrave dhe shërbimeve. Një vend mund të shpenzojë më shumë para se sa prodhon ,nga huazimi nga jashtë ose mund të shpenzoj më pak se sa prodhon dhe të jep hua të huajve. Ekonomia e tregut është kryesisht e lirë nga barrierat tregtare atëherë kur eksporti dhe importi përbëjnë një përqindje të madhe të produktit të brendshëm bruto. Kuptohet që asnjë ekonomi nuk është tërësisht e hapur apo tërësisht e mbyllur. Disa ekonomi shumë të hapura kanë pak apo aspak kufizime tregtare siç janë: tarifrat, por kjo është shumë e rrallë në praktikë, sepse gati se çdo ekonomi është e hapur në një fare mase. Ekonomia e hapur është shumë e varur nga tregtia ndërkombëtare e inporteve apo eksporteve të cilat janë të mëdha në raport me madhësinë e të ardhurave kombëtare ekonomike (Heckelmanand, 2000). Përveç kësaj, (Mickiewicz, Bell, 2013), theksojnë se përtej vendosjes së firmave sipas parimeve të tregut, procesi i liberalizimit gjithashtu përfshinte hapjen ekonomike, në të cilat sektori privat i brendshëm ishte i shtypur dhe i cili ishte i mbyllur nga ekonomia e madhe globale për të paktën dy gjenerata. Ndërkohë që liberalizimi i brendshëm dhe i jashtëm i çmimeve, hyrja në treg dhe tregtia e jashtme pritet të sjellin përfitime për konsumatorët nëpërmjet një përmirësimi të furnizimit të mallrave, më shumë zgjedhje dhe konkurrencë më të madhe, shumë firma vendase do të duhet të ristrukturohen në mënyrë dramatike nëse presin të mbijetojnë në një mjedis të ri ekonomik.⁸

⁸ PhD student, Department of Political Economics Doctorals School of Faculty of Economic and Business Administration "Alexandru Ioan Cuza" University, Iasi, fq. 243.

Grafikoni 4.. Mesatarja e hapjes ekonomike ne vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Kalkulim nga autori

Nga figura paraprake siç mund të shohim se Republika e Malit të Zi është renditur më së miri ku arrinë në vitin 2005 një mesatare më të lartë të hapjes ekonomike prej 104.8%, po ashtu edhe vendet si Maqedonia e Veriut dhe Bosna & Hercegovina kanë një dallim shumë të vogël në mes veti. Ndërkaq Maqedonia e Veriut me një mesatare prej 94.4% krahas Bosnjës dhe Hercegovinës me 0.01%, ndërsa Kroacia me një shkallë të hapjes ekonomike prej 83.5%, ndërsa Serbia dhe Shqipëria krahas vendeve tjera me një shkallë më të vogël të hapjes ekonomike prej 75.5%. Në bazë të këtij studimi mund të synojmë se hapja ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht është në tranzicion. Nga kjo mund të kuptohet se ekziston ndikim pozitiv i hapjes ekonomike mbi rritjen ekonomike.

2.4.1. Determinantet e Hapjes Ekonomike

Hapja ekonomike-përgjithësisht e konsideruar si liberalizimi i tregtisë - është kusht jetik për krijimin e një pozite të favorshme në tregjet ndërkombëtare. Ja pse shkallët e ndryshme të hapjes mund të shpjegojnë variacionet e rritjes ekonomike të vendeve për shkak të disa përcaktuesve. Ndër të parat që duhet përmendur është evolucioni i kursit të këmbimit,

luhatshmëria e të cilit mund të ndikojë në vëllimin e tregtisë, duke zvogëluar eksportet dhe duke rritur importet, ose anasjelltas. Kjo pasiguri që supozohet sjell momentin që vendi të arrijë të bashkëveprojë me pjesën tjetër të botës, kështu përmes qasjes në inpute të reja ose pjesërisht mbulon kërkesën e jashtme. Në literatura këto dy aspekte përdoren shumë shpesh për të matur shkalljen e hapjes ekonomike në mënyrë më të thjeshtë. Autorët i referohen raportit të vlerës totale të tregtisë së jashtme në produktin kombëtar si tregues kryesorë (Yanikkaya, 2003, 62). Lidhur ngushtë me tregtinë e mallrave dhe shërbimeve duket shpërndarja e faktorëve të prodhimit. Nga ana tjetër, dhënia e kontributeve të ndryshme ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi nivelin dhe diversitetin e prodhimit të brendshëm dhe mbi mallrat kualitativ të eksportit. Vendet e pasura me burime strategjike do të gjenerojnë një kërkesë potenciale të rritur që vjen nga më pak shtete të pajisura. Nga ana tjetër, vendi i varfër do t'i drejtonte importet në tregjet e vendeve të bollshme. Ajo që mund të mirret si shembull tipik në këtë pikë, është marrëdhënia midis vendeve të industrializuara dhe atyre më pak të zhvilluara. Shërbimet e këtij lloji kanë një dimension të caktuar dhe karakter fito-fito. Përveç kësaj, vendet në zhvillim përfitojnë nga transferimi i teknologjisë. Përparësia e Hapjes së ekonomive të tyre si dhe qasja zgjerimin e njohurive, rrit nivelin e tyre të brendshëm të produktivitetit. Lehtësimet e këtij procesi vin përmes tregtisë kombëtare e cila konsiderohet si kanal kryesor i transmetimit të teknologjisë inovative duke përcaktuar imitim ose zbatim të njohurive të huaja në fazat e prodhimit kombëtar.

Në bazë të këtyre veprimeve mund të rritet më tej cilësia e furnizimeve të reja dhe po ashtu vjen deri te përmirësimi i pozitës konkurruese në një mjedis të domosdoshëm (Wacziarg, 2001, 397). Të gjitha këto përcaktues mund të rigrupohen rreth kostove të transaksionit. Në udhëkryqin e shpenzimeve të transportit, furnizimi i inpueteve dhe sistemet inovative të prodhimit, mund të jenë gjithashtu të formuara nga distance tregtare në mes partnerëve tregtarë, fuqisë blerëse së monedhës tregtare, akumulimit të kapitalit ose telekomunikacionit. Prandaj, rritja e liberalizimit të këtyre sferave do t'i çojë në një hapje më të lartë ekonomike, e pasqyruar në rritjen e brendshme ekonomike. Kështu, duke i'u falenderuar kompanive multinacionale të cilat arrijnë të krijojnë një lidhje të frymëzuar të të gjithë kostove që lidhen me tregtinë ndërkombëtare, shkalla e hapjes mund të rritet përmes aktivitetit të tyre në

territore të ndryshme ekonomike. Ata përdorin portofolin ose investimet e drejtpërdrejta si instrumente vendimtare të orientimit të eksporteve, kualitetit të lartë, duke ruajtur besueshmërinë ndërkombëtare. Prania e kompanive shumëkombëshe në sektorët potencialisht produktiv, konsiderohet si një lloj kredie e dhënë për efikasitetin e ekonomisë kombëtare duke bërë thirrje për investitorë tjetër që të bashkohen.

Zgjerimi i mëtejshëm i sferës së ndikimit të përcaktuesve në këtë kohë, pjesëmarrja në një marrëveshje rajonale, tregon qartë shkallën e hapjes së një ekonomie kombëtare. Integrimi i thellë i shteteve anëtare tregon për rritjen e liberalizimit të tyre, por vetëm ndaj shteteve që janë pjesë e grupit rajonal. Pjesa tjetër e botës është afruar kryesisht në bazë të mbrojtjes.⁹

2.4.2. Efektet pozitive të hapjes ekonomike

Krijimi i premisave për efikasitet kombëtar arrihet përmes hapjes së tregtisë duke reduktuar ose eliminuar tarifatat dhe me aplikimin e barrierave jo-tarifore dhe po ashtu me një përmirësim të faktorëve mes vendeve, të reflektuara drejtpërdrejtë në nivelin e të ardhurave. Po ashtu, aplikimi i liberalizimit në llogarinë kapitale, eliminon masat kufizuese në kryeqytetet e huaja duke ofruar mundësi të reja investimi për agjentët e jashtëm ekonomik. Këto burime shitesë mund të financojnë deficitet eventual tregtar që mund të ndodhin nga importet e operuara nga degët e huaja në territorin kombëtar.

Duke shikuar në aspekt afatgjatë, implantimi i kompanive të huaja në ekonominë e vendit mundëson që të tërhiqen më tepër teknologji të reja. Pastaj produktiviteti i punës do të rritet duke pasur një efekt të dyfishtë. Do të arrihet që të përmirësohet konkurrenca e firmave lokale duke përcaktuar një rritje të eksporteve që transmetojnë të njejtin efekt tek nivelet e të ardhurave. (Vos et. Al., 2002, 125).

⁹ PhD student, Department of Political Economics Doctorals School of Faculty of Economic and Business Administration "Alexandru Ioan Cuza" University, Iasi, fq. 243.

2.4.3. Efektet negative të Hapjes Ekonomike

Është e kuptueshme që mekanizmat ekonomik nuk kanë vetëm eksternalitete positive, por në të njejtën kohë ato sjellin edhe kosto të caktuara. Për shembull, vendet që kanë përparësi të konsiderueshme krahasuese në tregtinë ndërkombëtare, përballen me rrezikun e inovacionit mbi ngopjen. Kjo rezulton që në afat të gjatë, hapja e tyre ekonomike mund të sjellë reduktim të produktivitetit. Pastaj kjo mund të çojë që inovacionet të kthehen në inpute të zakonshme nëse nuk bëhen investime në ngritje të vazhdueshme.

Duke ndryshuar këndvështrimin, një rritje e hapjes së ekonomisë mund të shtyjë qeverinë kombëtare që të fokusohet në mbrojtjen e prodhuesve vendas përballë goditjeve të jashtme. Subvencionet shtetërore provokojnë shtrembërim në shpërndarjen e burimeve duke dëmtuar rritjen vendase. Për situatën e anëtarësimit në një bllok tregtar rajonal, një iniciativë e tillë ndikon negativisht në tregun e brendshëm duke bllokuar qasjen në tregjet e caktuara për kompanitë që kanë origjinën në vendet e tjera anëtare¹⁰.

¹⁰ PhD student, Department of Political Economics Doctorals School of Faculty of Economic and Business Administration "Alexandru Ioan Cuza" University, Iasi, fq. 244.

3. RISHIKIMI I LITERATURËS

3.1. Aspekti Teorik

Literatura e viteve të fundit i ka dhënë rëndësi të veçantë aspektit të korrupsionit dhe pasojave nga i njëjti për shkak të prezencës së tij në mbarë botën. Shumë autorë korrupsionin e definojnë si sëmundje që është shkak i stagnimit ekonomik dhe pengesë për rritjen ekonomike. Për dallim nga vitet e mëhershme, sot bëhen debate të shumta në lidhje me korrupsionin dhe sidomos luftën kundër tij. Po ashtu, mosesuesi i vazhdueshëm i shumë vendeve në kontrollin dhe luftën kundër korrupsionit, jo vetëm që shkakton rënie ekonomike, por sjell krizën e demokracisë në botë. Vendet e Ballkanit Perendimor janë lider në sferën e korrupsionit me çka pason papunësia, inflacioni dhe me fjalë të tjera shkallë më e ulët e rritjes ekonomike.

Të gjitha burimet dhe studimet e deri tanishme e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja nga nëpunësit publik, marrëveshjet e fshehta në prokurorimet publike, ose përvetësimi i fondeve publike. Korrupsioni është i njohur që nga kohët më të lashta dhe nuk ka rreshtur së ekzistuari edhe sot. Edhe pse po ekzistonte në të gjitha pjesët e botës, shoqëritë shpeshherë i kanë ikur diskutimit rreth këtij realiteti. Pra, korrupsioni është fenomen i përhapur në të gjitha pjesët e botës, dhe është mendim i gabuar i atyre që mendojnë se korrupsioni është produkt i vetëm disa sistemeve. Me një fjalë mund të themi se: çdo kush që i shërben vetës, në mënyrë jo morale dhe jo etike, është korruptor. GRECO¹¹ korrupsionin e definojnë me marrjen e mitos në mënyrë direkte apo indirekte nga personi që i është besuar një funksion publik apo privat, me qëllim përfitimi për vete apo edhe për persona tjerë. Ndërsa autor tjerë kanë dhënë mendime tjera dhe ndryshe nga grupi me lartë i shteteve të BE , Murphy, Shleifer dhe Vishny kanë argumentuar se korrupsioni sjell rialokim të kapitalit human. (Mendez dhe Sepulveda ,2006) studiuat ndikimet e korrupsionit në periudhën afatgjatë duke përfshirë në model lirinë politike. Konkluzionet që nxorren ata tregojnë se marrëdhënia midis rritjes ekonomike dhe korrupsionit nuk është një marrëdhënie monotone (Lucas, 1988, 1990, 1993; Romer, 1990, Nureev, 2000).

¹¹ Grup shtetesh të BE'së ,kundër korrupsionit, të formuara më 1 maj 1999.

Sipas tyre, nëse korrupsioni është në nivele të ulta atëherë ka një impakt pozitiv në ekonomi, dhe kjo ndodh për periudhë afatgjatë ndërsa ndikimi i tij është negativ nëse është në nivele të larta. Ky konstatim vlen vetëm për vendet me nivel të lartë të lirisë politike.

3.1.1 Teoria Neoklasike

Ndryshe nga literaturat e tjera, literatura kryesore (neoklasike) mbi korrupsionin në ekonomi dhe shkencat shoqërore nuk e konsideron korrupsionin si pasojë të domosdoshme të demokracisë nën kapitalizëm. Krahas kësaj, kjo teori konsideron korrupsionin si një atribut të individëve të interesuar nga vetja që gëzojnë pushtetin shtetëror dhe nuk e lidh atë me llojin e demokracisë që kanë shoqëritë kapitaliste. Kështu, teoria neoklasike e korrupsionit, në pajtim me nxitjen më të madhe të ekonomisë neoklasike, për qeverinë thekson se ajo paraqet një entitet autonom që kërkon vetë rregulla dhe krijon rregullore në mënyrë që të zhvishet sa më shumë. Atë që nuk e përkrah teoria neoklasike është fakti se nuk e pranon tezën që korrupsioni është rezultati i pashmangshëm i zgjidhjes së kontradiktave e cila qëndron në bashkëjetesën e pabarazisë ekstreme ekonomike dhe barazisë politike në një shoqëri demokratike kapitaliste (Chandana Ghosh, Ambar Nath Ghosh, 2019).

Për sa i përket variables tjetër që e kemi objekt studimi dhe e cila është rritja ekonomike, neoklasikët janë të mendimit se teoria e rritjes ka për qëllim të shpjëgojë përcaktuesit e normave të rritjes së një vendi dhe arsyet për ndryshime në normat e rritjes dhe në të ardhurat për frymë midis vendeve. Nga ky aspekt, gjatë viteve 1950 dhe 1960, teoricientët e shihnin procesin e zhvillimit si një seri të fazave të njëpasnjëshme të rritjes ekonomike përmes të ciliave do të kalojnë të gjitha shtetet. Kjo teori më tepër ishte teori ekonomike e zhvillimit në të cilën sasia dhe përzierja e saktë e kursimeve, investimeve, dhe ndihmave të huaja ishte gjithçka që ishte e nevojshme për të mundur zhvillimin e vendeve (Todaro & Smith, 2006). Sipas disa mësimëve të teorisë neoklasike në të cilat janë të diskutuara shumë pak mirëqenia agregate ritet nga tregtia e lirë duke alokuar në mënyrë efçente burimet brenda vendeve. Pritshmëritë e disa nga përfaqësuesve të liberalizimit tregtar se nëse hiqen barrierat tregtare do të ket përfitime statike të larta në mirëqenie dhe si rezultat do të ket edhe një nivel më të ulët të varfërisë (Smith, 1776).

Përveç tjerash, kjo teori shpjegon rritjen ekonomike si funksion të ndryshimeve në katër faktorët: kapitali, puna, kapitali human dhe teknologjia (Romer 1990) por ajo që vazhdon të mbetet e diskutueshme është: Cilat politika ekonomike janë më të favorshme për rritje? Një linje e re e hulumtimit për lirinë ekonomike n'a përgjigjet siç është përgjigjur Adam Smith shumë kohë më parë. "Lirija Ekonomike" nënkupton shkallën në të cilën ekonomia e tregut është në vend, ku komponentat qëndror janë shkëmbyer vullnetarisht, konkurrenca e lirë dhe mbrojtja e personave dhe pronës (Geartney and Laesun 2002, s). Në teorinë neoklasike të rritjes ekonomike njihen tre burime në modelin Neoklasik tradicional të cilat janë: përmirësimet në teknologji, të rritet sasia e punës dhe cilësisë, si dhe rritjet në kapital (Todaro & Smith, 2006).

Në lidhje me raportin midis rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike shumë autorë kanë mendime të specifikuara. Për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike kanë dhënë mendime të ndryshme shumë autorë të tillë si (Dollar, 1992), Sachs and Warner, 1995, Edwards, 1998, Frankel dhe Romer, 1999), të cilët theksojnë se vendet të cilat janë në zhvillim në periudhën e kaluar kanë ndërmarrë një proces të liberalizimit e cila ka shkaktuar brenga se mos do të shkaktoj ulje të varfërisë edhe në afat të shkurt edhe në afat të gjat. Sipas tyre, liberalizimi është i dëmshëm për agjentët të cilat janë të varfër në ekonomi (Oxfam International, 2003 dhe 2005), ndërsa sipas, Winters et al. (2004), thonë se liberalizimi ndikon në çdo shtresë të varfërisë dhe çdo ekonomi familjare ndryshon nga njëra tjetra, mirëpo në një studim të OBT-së , Winters (1999) nxjerr në konstatim se liberalizimi tregtar zbut varfërinë dhe sipas kësaj, nëse kemi rritje ekonomike kjo ndikon në uljen e varfërisë, kjo rritje arrihet nga tregtia e lirë.

3.1.2 Teoria Neokenzianje

Në lidhje me rritjen ekonomike, teoria tipike Kejniane spjegon faktin që niveli i ulët i borxhit publik mund të çojë në rritjen ekonomike dhe po ashtu një niveli i lartë i borxhit publik ka ndikim negativ në rritjen ekonomike, dhe kjo mund të karakterizohet me, rritjen e tatimit, rënien e investimeve dhe rritjen e shpenzimeve të konsumit. Shumë studiues kanë studiuar ndikimi e shpenzimeve qeveritare që ka në rritjen ekonomike, por ekziston një mungesë në literaturat për këtë çështje në vendet të zhvilluara, si dhe ka një mungesë të analizës empirike. Borxhi publik është rritur gjatë krizës financiare të vitit 2008 me çka është shkaktuar tendosje e

konsiderueshme në financat publike. Borxhi publik ndikon në zvogëlimin e rritjes ekonomike nëpërmjet tre kanaleve kryesore: Grumbullim i investimeve, si rezultat i rritjes së taksave të nevojshme për aneksimin e borxhit, redukton shpenzimet e atyre që nuk i deklarojnë tatimet, dhe konsiderohet si një politikë efektive në procesin e inkasimit të buxhetit shtetëror. Normat e larta afatgjata do të rrisin koston e kapitalit, duke u përqendruar me shumë në investime publike, dhe më e rëndësishmja duke reduktuar investimet private, e cila në periudhat afatgjata mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike (Elmeskov dhe Sutherland, 2012).

Në lidhje me papunësinë, sipas teorisë Kejniane, një papunësi e lartë mund të shihet si një furnizim i tepërt i fuqisë punëtore, por nëse ekziston një furnizim i tepërt i punës, mund të pritet që çmimi i shërbimeve të punës ose me fjalë të tjera, paga të bjerë. Ekonomistët kejnian besojnë se tregu i punës të mos reagojë shpejtë në këtë drejtim. Kjo i çon ato në konkluzion se ekonomia të vuajë nga kërkesa deficitare (papunësia deficitare) e cila kërkon intervenimin e shtetit (Heather, 2000).

Një pjesë e madhe e ekonomistëve janë munduar të japin sqarime në lidhje me atë se si do të ndikon hapja ekonomike në rritjen ekonomike dhe nga teoria vërejmë se nëse në vend ekziston më tepër liri, atëherë njerëzit do të jenë më të lirë për të realizuar bizneset e tyre, do të zvogëlohet varfëria, gjithashtu do të zvogëlohet papunësia dhe do të ketë një rritje të mirëqenies ekonomike. Pra, mund të themi se do të ketë më shumë përfitime edhe pse kjo nuk është plotësisht e saktë sepse hapja ekonomike ka edhe disa ndikime negative. Por, në përgjithësi hapja ekonomike do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike duke u mundësuar vendeve në zhvillim të arrijnë një ekonomi më të zhvilluar.

3.2. Evidenca empirike

Për sa i përket efekteve të korrupsionit mund të themi se janë shumë dimensionale. Ndër të tjerët që kanë studiuar ndikimet e korrupsionit në periudhë afatgjate ishin (Mendez dhe Sepulveda, 2006) të cilët në modelin e tyre përfshijnë lirinë ekonomike. Sipas tyre, marrëdhënia midis korrupsionit dhe rritjes ekonomike nuk është një marrëdhënie monotone.

Në bazë të evidencës empirike të autorëve të tjerë shohim se korrupsioni ka pasur efekt anësor për sa i përket rritjes ekonomike siç cekëm edhe më lartë nga evidenca e tyre empirike ato arritën në përfundim se kapitali human luan një rol kyç në rritjen ekonomike (Ulucas, 1988, 1990, 1993; Romer, 1990, Nureev, 2000). Sa i përket ndikimit të korrupsionit në rritjen ekonomike, studimet e shumta empirike kanë treguar se aifrenon rritjen ekonomike (Mauro, 1995, 1997, 1998, Tanzi, 1998, Kaufmann dhe Wei, 1999). Në një tjetër studim të bërë nga (Meon dhe Sekkat, 2005) u analizua po ashtu impakti i korrupsionit mbi rritjen. Ky impakt është i varur jo vetëm me ndikimin e korrupsionit në nivelin e investimeve, por edhe me cilësinë e qeverisjes. Sipas tyre, korrupsioni përkeqëson cilësinë e qeverisjes. Përmes këtij studimi të realizuar, ato nuk ishin dakord dhe e kundërshtuan teorinë e Leff-it sipas të cilit korrupsioni shërbente si lubrifikant për ekonominë dhe e cilësuan atë si rëra për rrotat e një makine. Studimi nga Mauro (1995) zbuloi se pjesa më e madhe e rritjes së korrupsionit vjen nëpërmjet ndikimit të saj në investime, ndërsa Pellegrini dhe Gerlagh (2004) theksuan se efektet jodirekte të korrupsionit në kapitalin human, stabilitetin politik dhe hapjen tregtare janë gjithashtu të rëndësishme. Korrupsioni mund të sjell uljen e normës së rritjes ekonomike përmes mbledhjes të taksave, nivelit të shpenzimeve publike dhe përbërjes së shpenzimeve qeveritare. Po ashtu një studim të ngjajshëm ka bërë edhe Lui (1996), por ai studio efektet e korrupsionit edhe në periudhë afatshkurtër edhe në periudhë afatgjate. Sipas tij, në periudhë afatshkurtër korrupsioni ndikon në mënyrë pozitive në efikasitetin alokative, kurse në periudhë afatgjatë ndikon negativisht në rritjen ekonomike të një vendi. Ai tregoi se nëse korrupsioni është në nivele të ulëta, atëherë ka një impakt pozitiv në ekonomi, ndërsa ka impakt negative nëse është në nivele të larta. Për të dhënë konstatim për këtë që thamë më lartë, (Keefer, 1995, 1997), (Sachs dhe Warner, 1997), (Pelegrini dhe Gerlagh, 2004), arritën të vërtetojnë se korrupsioni ka efekt negativ në rritjen ekonomike në vendet në tranzicion, konkretisht në vendet e Ballkanit Perëndimor. Rose-Ackerman sugjerojnë se qeveritarët e korruptuar ose zyrtarët mund të preferojnë kryerjen e atyre shpenzimeve që i mundësojnë atyre mbledhjen e rryshfeteve dhe për t'i mbajtur ata të fshehtë. Përveç kësaj, me rëndësi të veçantë është analiza e marrëdhënies midis rritjes ekonomike dhe papunësisë, në bazë të të cilave analizave është konstatuar se si faktor që ndikon në rritjen ekonomike ishte edhe papunësia, si një fenomen shumë i përhapur

në veçanti në vendet në tranzicion për të cilën kanë hulumtuar shumë studiues të ndryshëm nga mbarë bota. Studimet e tyre më së shumti lidhen me faktorët që sjellin rritjen e shkallës së papunësisë. Kështu, studime të shumta empirike kanë treguar se papunësia në ekonomitë e tregut gjithashtu ka tendencë të ndryshojë sipas moshës dhe shkathtësisë. Me kalimin e kohës, vende të ndryshme më pak të afta dhe më pak të arsimuara, janë më të ndjeshme ndaj luhatjeve në punësim përgjatë ciklit të biznesit dhe në përgjigje të ndryshme në pagën reale. Sipas tyre, aftësitë maten në mënyrë tipike nga lloji i punës së kryer, për shembull aftësitë ose paaftësitë manuale ose jo-manuale dhe kështu me rradhë. Shumë studime dhe hulumtime janë kryer rreth çështjes së raportit të rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike. Rreth kësaj çështje të rritjes ekonomike përmes hapjes ekonomike është deklaruar edhe Snoy (2011) sipas të cilit, çështja e një shtrirje në të cilën politikat tregtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor mund të kontribuojnë në rritjen ekonomike të tyre, mbeten drejtpërdrejt të lidhura me marrëdhëniet midis liberalizimit të një tregtie të jashtme dhe stimulimit të rritjes. Për të shmangur një ngadalësim të eksporteve si një motor për rritjen ekonomike, rajoni do të duhet të bëjë përpjekje përveç shmangies së barrierave tarifore edhe tejkalimin e pengesave jo-tarifore ndaj tregtisë dhe përmirësimit të mjedisit institucional (Snoy, 2011). Nga ana tjetër, lidhje pozitive midis lirisë ekonomike dhe rritjes ekonomike kanë hasur edhe në studimet empirike të shumë autorëve si për shembull (Barro,1991, 1994; Scully dhe Slottje, 1991; De Vanssay and Spindler, 1994; Torstensson 1994). Disa nga këto studime kanë përdorur një ose dy indikatorë të lirisë ekonomike të tillë si çmimi i tregut të zi, në këmbimet e huaja, ku të tjerët kanë përdorur tregues të ndryshëm të lirisë ekonomike. Sidomos vendet të cilat janë të varfëra ata përfitojnë nga liberalizimi tregtarë. Fakti që liberalizimi tregtar nxit rritjen ekonomike pranohet edhe ndërkombtarisht (Harrison ,1996; Paulino ,2002; Wacziarg , 2001). Gjithashtu për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike kanë dhënë mendime të ndryshme shumë autorë të tillë si Dollar (1992), Sachs and Warner (1995), Edwards (1998), Frankel and Romer (1999). Sipas konkluzioneve të tyre, vendet të cilat janë në zhvillim në periudhën e kaluar kanë ndërmarë një proces të liberalizimit e cila ka shkaktuar brenga se mos do të shkaktoj ulje në varfërinë sepse edhe në afat të shkurt edhe në afat të gjat liberalizimi është i dëmshëm për agjendët të cilat janë të varfër në ekonomi (Oxfam International, 2003 dhe 2005).

4. METODOLOGJIA

Gjatë këtij punimi do të përdorim metoda të ndryshme me qëllim që rezultatet tona të kenë konfidencë shkencore: Metoda Panel data modelet, e cila është një teknikë statistikore që përdor tre qasje: qasja fikse, qasja e rastësishme dhe qasja Husmman–Taylor. Të dhënat që do i përdorim në ndërtimin e modelit kryesishtë do i marim nga institucionet financiare si nga Bankat Qëndrore të vendeve përkatëse dhe nga Banka Botërore, por edhe nga institucione të tjera relevante. Pasi të kem përfunduar rishikimin e evidencës empirike të ndikimit të faktorëve dhe variablave që kanë pasur një influencë në rritjen dhe hapjen ekonomike, siç është korrupsioni dhe variabla të tjera që kanë ndikim negative në rritjen dhe hapjen ekonomike, nëpërmjet modeleve dhe metodave ekonometrike do të testojë se si ndikojnë këta faktor makroekonomik në rritjen dhe hapjen ekonomike vendeve të Ballkanit Perëndimor. Si hap i parë do të jetë specifikimi i modeleve ekonometrike në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe më pas do të analizojë të dhënat në hulumtimin shkencor, si dhe do të bëjë përlogaritjen e modeleve ekonometrike dhe interpretimin e rezultateve të tyre. Po ashtu, në këtë pjesë të punimit shkencor do të paraqitet edhe analiza empirike për testimin e variablave kryesore që ndikojnë pozitivisht ose negativisht në rritjen dhe hapjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor siç është rasti me korrupsionin, pastaj edhe papunësinë.

Për arsye se Panel Data është një metodë statistikore, e përdorur gjerësisht në shkencat të ndryshme dhe e cila merret me observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve edhe atë: "Cross Sectional dhe Times Series"¹², të njejtën metodë do t'a shfrytëzojmë për observimin e të dhënave tona relevante të cilat grumbullohen me kalimin e kohës dhe mbi të shtetet që i kemi në observim dhe pastaj drejtohet një regresion mbi këto dy dimensioneve. Analiza multidimensionale është një metodë ekonometrike në të cilën të dhënat grumbullohen në më shumë dimensioneve, edhe atë: tipike, kohore, individuale dhe në disa raste të dimensioneve të treta. Njëkohësisht, përmes Panel Data kontrollohen edhe disa variablave të tjera të cilat nuk janë të përfshira në model, duke mos i futur ato në observim, por duke observuar ndryshimet në variablat e varur përgjatë kohës.

¹² Davies, A.; Lahiri, K. (1995). "A New Framework for Testing Rationality and Measuring Aggregate Shocks Using Panel Data". *Journal of Econometrics* 68 (1): 205–227. doi:10.1016/0304-4076(94)01649-K.

4.1. Modeli Pooled OLS

Rasti më i thjeshtë i përdorimit të të dhënave dhe informacioneve në formën gjatësore realizohet duke injoruar strukturën panel të të dhënave. Pasi të dhënat janë të organizuara nga njësitë vendimmarrëse, atëherë modeli mund të shkruhet si vijon:

Ekuacioni.1.

$$Y = X\beta$$

Variabla e varur (Y) është variabla e projektuar apo e vlerësuar që kërkohet të parashikohet ose të shpjegohet me anën e një variable tjetër. Variabla e pavarur (X) është variabla që siguron bazën për vlerësim. Me anë të kësaj variable bëhet shpjegimi i variablit të varur. Në këtë rast, për një 'X' të dhënë, nuk ka asnjë korrelacion serial midis observacioneve dhe për më tepër, gabimet nuk janë heteroskedastik. Me fjalë të tjera, supozohet që observacionet individuale me kalimin e kohës janë observacione nga individ të ndryshëm. Një qasje e tillë mund të jetë e arsyeshme, për shembull, në rastet kur madhësia e mostrave ndër-sektorial (cross-sectional) është e vogël. Gjithsesi, duke mos e integruar strukturën panel të të dhënave si dhe duke menduar se termat e gabimit të njohur si "Error Terms", atëherë ky proces çon në rezultate që nuk janë të përshtatshme në të shumtën e rasteve. Vlerësuesi Pooled OLS do të përdoret në këtë hulumtim empirik, ngjashëm me studime të tjera të aplikuara, si një fillim për analizat empirike, ku rezultatet e tij do të krahasohen me rezultatet nga modelet që janë më të përshtatshme për analizën e të dhënave panel. Tre modelet që do të përdorim në këtë punim të temës së masterit janë: "Fixed Effects", 'Random Effects' si dhe 'Hausman-Taylor IV'¹³. Vlerësuesi Pooled OLS është jo konsistent nëse modeli i vërtetë është modeli Fixed Effects. OLS është i përshtatshëm nëse koeficienti konstant ose modeli Random Effects është i përshtatshëm, por duhet të përdoren gabimet standarde të korrigjuara në panel dhe t-statistikat për përfundimin statistikor¹⁴.

¹³ Cancado, P.L. (2005), 'Economic Growth: Panel Data Evidence from Latin America', Center for International Studies, f.19.

¹⁴ A. Colin Cameron, Pravin K. Trivedi, Microeconometrics-Methods and Applications, f. 702.

4.2. Modeli Fixed Effects

Fixed effect është një model i cili trajton relacionin në mes variablave që i parashikon dhe rezultatet e variablave brenda një njësie ekonomike ku çdo njësi ka karakteristikat e veta të veçanta që mund ose nuk mund të ndikojnë variablat parashikuese. Thënë ndryshe Fixed effect paraqet një model statistikor i cili përfaqëson sasi të vrojtuar në drejtim të variablave shpjeguese të cilat parqiten sikur sasi të ishin jo të rastësishme. “Fixed Effects”, kjo qasje nuk kërkon eliminimin e variablave shpjegues që variojnë përgjatë kohës "Time-Variant"¹⁵. Përdorimi i efekteve fikse bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë analizimin e ndikimit të variablave që ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse trajtojnë marrëdhëniet në mes parashikuesve dhe rezultateve të variablave brenda një njësie ekonomike (vendi, personi, kompani, etj). Çdo njësi ka karakteristikat e veta të veçanta që mund ose nuk mund të ndikojnë variablat parashikuese¹⁶.

Ekuacioni.2.

$$Y_{it} = \beta_1 \times X_{it} + \alpha_{it} + u_{it}$$

Ku kemi:

“ $(i=1\dots n)$ ” është intercepti i panjohur për secilin entitet (**‘n’** entitet-intercepte specifike)

‘ Y_{it} ’ është variabla e varur (DV) ku **‘i’**=entiteti dhe **‘t’**=koha.

‘t’ përfaqëson një variabël të pavarur

‘ β ’ është koeficienti për variablën e pavarur.

u_{it} ” është ‘error term’.

¹⁵ Cancado, P.L. (2005), "Economic Growth: Panel Data Evidence from Latin America", Center for International Studies, f.25.

¹⁶ UCLA Resources <http://www.ats.ucla.edu/stat/>

4.3. Random Effects

Në statistika, një model i efekteve të rastit, i quajtur edhe një model i përbërësve të variancës, është një model statistikor ku parametrat e modelit janë variabla të rastit. Kjo është një lloj modeli linear hierarkik, i cili supozon se të dhënat që analizohen janë nxjerrë nga një hierarki e popullsisive të ndryshme dallimet e të cilave kanë të bëjnë me atë hierarki. Në ekonometrikë, modelet e efekteve të rastësishme përdoren në analizën e të dhënave hierarkike ose të panelit kur nuk përfillen efekte fikse. Modeli i efekteve të rastësishme është një rast i veçantë i modelit të efekteve fikse (Alison, 2009).

Modeli Random effect paraqitet si model i rastit dhe arsyeja e përdorimit të këtij modeli është se ndryshon nga modeli i efekteve fikse, variacioni i të gjitha subjekteve supozohet të jetë i rastësishëm, dhe është i pa lidhur me parashikuesit dhe variablat tjera të pavarura të përfshira në modelin ekonometrik. Në ekonometri, në rastet ku nuk ka efekt fiks e cil ka të bëjë me efektet individuale është përdorur modeli "Random Effects" për të analizuar të dhënat hierarkike apo panel të dhënat. Modeli "Random Effects" është një rast i veçantë i modelit "Fixed Effects". Ky model ndryshe paraqitet si model i rastit dhe në qoftë se kemi një variabël të varur në model atëherë ne do të përdorim modelin Random, pra modelin e efektit të rastit, në të cilin në të dhënat analizohen analizohen në koordinim nga një hierarki të popullsisive të ndryshme.

Ekuacioni i modelit Random effect:

Ekuacioni.3.

$$Y_{xit} = \beta_{zit} + \alpha + u_{it} + \epsilon_{it}$$

Në model kemi përdorur variabla shpjeguese dhe këto variabla i kemi paraqitur në hulmuntim, që supozohen të jenë endogjene, kurse në rastin tonë modelet "Fixed effects" dhe "Random effects", janë përdorur vetëm për qëllime krahasimore¹⁷.

¹⁷ Beyond "Fixed Versus Random Effects": A framework for improving substantive and statistical analysis of panel, time-series cross-sectional, and multilevel data" / Brandom Bartels <http://polmeth.wustl.edu/retrieve.php?id=838>

4.4. Modeli Hausman Taylor-IV

Pasi që trajtuam modelin fiks dhe atë të rastit, vërejtëm se shumë studiues kanë arritur rezultate mjaftë relevante duke përdorur modelin (Hausman dhe Taylor , 1981), duke kombinuar të dy modelet “Fixed Effects” dhe “Random effects”, të cilët i trajtuam më herët dhe me këtë ne arrijmë në një metodë më të avancuar dhe më praktikuese siç është metoda e Hausman Taylor IV. Ky model "Hausman dhe Taylor" është gjithmonë konsistent dhe efikas. Një avantazh që e dallon nga qasjet tjera është se kjo qasje nuk përdor instrumente të jashme.

Modeli Hausman Taylor (1981) shkruhet si më poshtë:

Ekuacioni.4.

$$Y_{xit} = X_{it} + Z_{in} + \alpha_i + u_{it}$$

Hausman Taylor ndanë Z dhe X:

$$X=[X1;X2] \text{ dhe } Z=[Z1;Z2]$$

Ku: X1 është nxk1 ; X2 është nxk2 .

Z1 është nxg1 kurse Z2 është nxg2 dhe n-NT

Ekuacioni.5.

$$Y_{it} = X_{1it} + b_1 + X_{2it} + \alpha_i + Z_{it}Y_1 + Z_{2it}Y_2 + \alpha_i + n_{it}$$

Ku:

$$Y=(Y1,Y2).B=(B1,B2) \text{ dhe } y=(y1,y2)^{18}$$

¹⁸ B.H. Baltagi et al. / Economics Letters 79 (2003) 361–369.

4.5. Zgjedhja në mes Fixed effect dhe Random effect duke e përdorur Hausman Test –in

Për të bërë zgjedhjen midis modelid Fixed Effects dhe Random Effects, ne përdorim Hausman test (1978). Testi Hausman është një test kryesisht statistikor që në ekonometri bën të mundur testimin e hipotezave i emëruar nga Jerry A.Hausman. Pra, Hausman test n'a mundëson që të shohim se cili model është më efikas dhe cili model është më pak efikas që rezulton me faktin se jep rezultate më të sakta. Pra, përmes këtij testi bëhet krahasimi midis fixed effect dhe random effect. Ky test n'a mundëson që të bëjmë testimin e hipotezës zero së koeficienteve të vlerësuar. Testi i Hausmanit është një procedurë mjaftë e përgjithshme që nuk shpreh në mënyrë eksplicite një hipotezë alternative dhe për këtë arsye nuk ka nevojë të ketë fuqi të madhe kundër një alternative të veçantë (Cameron, Trivedi, 2005).

4.6. Vlerësimi i modeleve

Në këtë hulumtim me karakter shkencor kam përdorur modelin “ Hausman-Taylor IV” për të vlerësuar ndikimin e korrupsionit, për vendet e Ballkanit Perëndimor në periudhën 2008-2017. Po ashtu, në këtë punim do të gjeni rezultatet e “Podel OLS”, “Fixed Effects” dhe “Random Effects”. Duke u bazuar në supozimet e mësipërme si dhe duke u mbështetur nga rezultatet e “Hausman Test”, metoda “Hausman-Taylor IV” konsiderohet të jetë më e përshtatshme dhe më e saktë se dy modelet e tjera “Fixed Effects” apo “Random Effects”. Gjatë specifikimit të modelit ekonometrik, si variabla të pavarura do të marrim indeksin e korrupsionit dhe papunësinë ,ndërsa si variabël të varur kemi vendosur rritjen ekonomike dhe hapjen ekonomike tek vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu edhe rezultatet e fituara nga përdorimi i modeleve “ Fixed Effects”, dhe “Random Effects” do të paraqiten në këtë hulumtim, por si model bazë për vlerësimin e variablave do të zgjedhim modelin e HausmanTaylor, ku njëkohësisht do të jap argumente dhe fakte relevante për të vërtetuar saktësinë e këtij modeli kundrejt modeleve tjera.

5. Interpretimi i rezultateve

Në këtë pjesë të punimit do të interpretohen rezultatet e OLS me gabimin standard të besueshëm (robustness error standard), Fixed effects, Random effects, ndërsa si model të zgjedhur do t'a marim për interpretim modelin e Hausman Taylor-IV, ku do të japim argumente të mjaftueshme për sa i përket besueshmërisë së këtij modeli. Gjithashtu Hausman-Taylor e zgjedh problemin e endogjenitetit i cili është mjaftueshëm i rëndësishëm gjatë përdorimit të metodës së katrorëve të vegjël në modelet panel. Në vijim do të raportojmë rezultatet e modelit ekonometrik të specifikuar dhe analizës së të dhënave në seksionet më lartë (Shih në appendix B).

Tabela 4. Testimi i determinantave të rritjes ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor

Variablat	OLS	Random Effects	Fixed effects	Hausman Taylor-IV
Rritja ekonomike		0.3376322	0.024865	0.0473408
Papunësia	-0.120126	-0.0797466	0.2310115	-0.0283517
Korrupsioni	-3.184644	-2.010984	-1.564961	-1.659988
Hapja ekonomike	0.1352506	0.099118	0.1031101	0.0552029
Konstanta	9.621041	5.416815	-2.934149	
Observimet	69	69	69	69
Koeficienti	7.92		0.61	
Gabimi standard	0.2676			
chi2	N/A	35.6	N/A	1.43
Modeli	OLS	RE	FE	HT-IV

Burimi: Llogaritur nga vetë autori perms të dhënave numerike në programin e avancuar STATA 12.

Më lartë e kemi theksuar se korrupsioni ka ndikim negativ mbi rritjen ekonomike dhe kjo në veçanti në periudhë afatgjatë, madje kjo është më e shprehur në vendet në tranzicion, gjë të cilën e kanë konkluduar edhe shumë autorë në studimet e tyre si për shëmbull

Lambdsdorff (1999) arinë në përfundim se korrupsioni pengon rritjen ekonomike. Në të njejtin konstatim kemi arritur edhe duke u bazuar në modelet e përdorura në këtë hulumtim, ku përmes të dhënave që n'a japin modelet Random effect, Fixed effect si dhe të dhënat më të sakta që nxirren nga modeli i Hausman Taylor-IV, arrijmë të konstatojmë se korrupsioni e afekton negativisht rritjen ekonomike. Prandaj, nëse kemi një rritje prej 1% të indeksit të korrupsionit, kjo do të çoj në ulje ekonomike prej -1.65%, ku gjithashtu kemi gabimin standard (se=1.8), Random effect (se=1.13), Fixed effect (se=1.85). mund të themi se pranohet hipoteza e parashtruar në punim: **H1/3: Korrupsioni ndikon negativisht në rritjen ekonomike.**

Në lidhje me variablën tjetër e cila është papunësia, të dhënat që n'a japin modelet Fixed effect, Random effect dhe Hausman Taylor-IV, tregojnë se një rritje prej 1% e papunësisë do të çoj në ulje ekonomike prej -0.02%, (se=0.11), Fixed effect (se=0.1), Random effect (se=0.03). Për arsye se me ulje të pagave, konsumi nga ana tjetër do të tkurret, kështu që edhe shumica e ekonomistëve janë dakord se shkak i papunësisë së lartë është kriza ekonomike. Papunësia ndikon negativisht në rritjen ekonomike sepse nëpërmjet uljes së papunësisë do të kemi rritje ekonomike dhe e kundërta do të ndodh nëse kemi rritje të papunësisë kjo do të redukton rritjen ekonomike. Nga rezultatet më lartë pranohet hipoteza se **H2/3: Papunësia ndikon negativisht në rritjen ekonomike.**

Përveç konkluzioneve që kanë arritur autorë të shumtë në studimet e tyre lidhur me hapjen ekonomike, e cila ka një impakt pozitiv mbi rritjen ekonomike, në të njejtën kohë edhe modelet Fixed effect, Random effect dhe modeli Hausman Taylor-IV japin të njejtin konstatim. Të dhënat e këtyre modeleve janë të dhëna relevante, veçanërisht modeli i Hausman Taylor-IV i cili mat në mënyrë më të sakt variablat.

Nga rezultatet të cilat i kemi kalkuluar arrijmë në përfundim se nëse kemi një rritje prej 1% të indeksit të hapjes ekonomike, kjo do të rezultoj në rritjen ekonomike prej 0.05%, ku kemi gabimin standard (se=0.18), ndërsa në modelin Fixed effect e kemi (se=0.18) dhe në Random effect (se=0.11) dhe nga kjo arrijmë në përfundim se pranohet hipoteza: **H3/3: Hapja ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike.**

KONKLUSIONE

Qëllimi primar i këtij hulumtimi është të jap një pasqyrë të qartë rreth ndikimit të korrupsionit në rritjen ekonomike si dhe në hapjen ekonomike, por edhe ndikimin e hapjes ekonomike në rritjen ekonomike.

Gjithashtu këtu përfshihet edhe një variabël tjetër e cila është papunësia për të cilën është hulumtuar ndikimi i saj në rritjen ekonomike. Ky studim shkencor ofron një analizë për ndikimin e korrupsionit, papunësisë dhe hapjen ekonomike. Si e afektojnë ato rritjen ekonomike. Përveç kësaj, në këtë studim identifikohet edhe ndikimi pozitiv i variablave sepse disa nga variablat që i kemi përfshirë në studim afektojnë pozitivisht dhe disa variabla ndikojnë në mënyrë negative në rritjen ekonomike.

Për të vërtetuar hipotezat kam përdorur teknika të ndryshme, Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effect, Hausman Taylor-IV. Rezultatet që i kam marë nga modeli Pooled OLS i kam krahasuar me rezultatet e mara nga modelet siç janë: Fixed effect dhe Random effect por për shkak të saktësisë që ofron modeli i Hausman Taylor –IV, i njejti është përdorur për të interpretuar rezultatet.

Rezultatet e fituara nga modelet që i përmendëm më lartë, japin hapësirë të vim në konkluzion se korrupsioni ka ndikim negativ mbi rritjen ekonomike, apo raporti i tyre është i zhdrejtë, me arsyetimin se vendet që identifikohen me korrupsion të theksuar, i ndejnë pasojat dhe vuajtjet nga i njejti për shkak se korrupsioni ndikon në largimin e investitorëve potencial, pra, mundëson çrregullimin e klimës së investimeve, çrregullon konkurrencën dhe mjedisin biznesor, me një fjalë, vendet që janë në tranzicion, posaçërisht vendet e Ballkanit Perëndimor humbin besimin nga investitorët e jashtëm me çka zbehet imazhi i vendeve përkatëse. Përveç kësaj, dëmet që sjell korrupsioni janë të kushtueshme për shkak se ai rrit koston e të mirave dhe shërbimeve, sjell investime të panevojshme, si dhe ul cilësinë e shërbimeve të infrastrukturës. Ajo që mund të konkludojmë në këtë pikë është fakti se vendet më të prekura nga korrupsioni janë vendet në zhvillim, ndërsa tek vendet e zhvilluara shkalla e korrupsionit është më e ulët, me çka kemi pranuar hipotezën e parë të parashtruar se **korrupsioni ndikon negativisht në rritjen ekonomike**. Ndikim negativ ndaj rritjes ekonomike ka edhe papunësia, gjë të cilën n'a tregojnë të dhënat tona dhe në të njejtën kohë edhe studimet e ndryshme të

cilat theksojnë se sa më i lartë të jetë niveli i papunësisë, aq më i ulët do të jetë niveli i rritjes ekonomike, sepse raporti në mes tyre është i zhdrejtë. Përveç varfërisë dhe standardit të ulët që sjell papunësia, një fakt i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë është se papunësia ndihmon në rritjen e kriminalitetit dhe shfaqjen e dukurive të tjera negative. Pra, efekti negativ i papunësisë nuk shfaqet vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në atë social. Në bazë të kësaj dhe rezultateve që kemi arritur t'i nxjerrim nga analizat tona, mund të pranojmë hipotezën e dytë të këtij studimi e cila pohon se **papunësia ndikon negativisht në rritjen ekonomike**. Në fund të këtij hulumtimi empirik, është paraqitur lidhja në mes hapjes ekonomike dhe rritjes ekonomike, raporti mes të cilëve është i drejtë. Rezultatet e fituara në lidhje me hapjen ekonomike, gjegjësisht ndikimin e saj në rritjen ekonomike, tregojnë se hapja ekonomike afekton në mënyrë pozitive rritjen ekonomike. Vendet të cilat kanë hapje ekonomike më të madhe, kanë pasur një lulzim ekonomik. Vendet me nivel më të lartë të hapjes ekonomike janë më productive. Prandaj, vendet që kanë deficit tregtar, siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor, e kanë më se të nevojshme krijimin e kushteve për liberalizim ekonomik sepse duke marrë parashysh shembujt që paraqiten nga vendet perëndimore mund të shohim se liberalizimi ekonomik ka ndikuar që në ato vende të ulet shtresa e varfërisë. Pra, përmes liberalizimit tregtar mund të arrihet zbutja e varfërisë, duke krijuar kushte dhe mundësi për investime të reja, për krijim të vendeve të reja të punës, për eksport më të zhvilluar se sa import, për tërheqje të teknologjive më të avancuara të cilat do të ndihmojnë në arritjen e produktivitetit të punës dhe sipas kësaj, nëse kemi rritje ekonomike kjo do të ndikojë në uljen e varfërisë, gjë e cila arrihet përveç tjerash edhe përmes tregtsë së lirë. Tani, është shumë i lehtë vërtetimi i hipotezës së tretë e cila pohon se **hapja ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike**.

REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi mund të themi se për të patur një stabilitet ekonomik dhe shkallë më të lartë të rritjes ekonomike, është e domosdoshme ulja e nivelit të korrupsionit, njëkohësisht edhe ulja e shkallës së papunësisë dhe rritja e hapjes ekonomike.

Të tri këto variabla kanë impakt njëra në tjetrën, gjë që n'a tregon se duhet bërë kombinim i mirëfilltë në mes këtyre indikatorëve që të kemi stabilitet dhe mirëqenie ekonomike.

Për sa i përket korrupsionit, është më se e qartë se paraqitja dhe përhapja e tij mundëson që një ekonomi në mënyrë të vazhdueshme të pësojë rënie dhe pastaj ngritja e saj është shumë e vështirë dhe kërkon kohë shumë të gjatë sepse vetë luftimi i korrupsionit nuk është aspak i lehtë dhe kjo nuk është aspak e përballueshme për një shoqëri në tranzicion. Ajo çka mund të sugjerojmë në këtë pikë është fakti që të ulët niveli i korrupsionit përmes kontrollit të vazhdueshëm dhe mbikëqyrje të vazhdueshme ndaj institucioneve dhe bizneseve të ndryshme. Nga ana tjetër, ne e dimë faktin se korrupsioni ka shumë kosto dhe është shumë i vështirë për t'u menaxhuar dhe kontrolluar sepse është një proces kompleks. Është më se e nevojshme që në vendin tonë dhe vendet përreth të prekura nga korrupsioni, siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor, të kenë transparencë në të gjitha fushat, transparencë në institucionet e shtetit dhe ato private. Të kontrollohen dhe të publikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë se si vinë dhe ku shkojnë paratë e popullit. Politika njëherë e përgjithmonë të ngre dorë nga inkuadrimi në çdo fushë të mundshme me qëllim që të lejojë që çdo institucion, biznes ose edhe shteti, të funksionojë në mënyrë ligjore, sepse me korrupsion ato që fitojnë janë grupe të caktuara të interesit, partitë politike ose individ të caktuar që përfitojnë nga kjo mundësi. Mos të ketë anashkalim dhe neglizhencë në dënimet që u shqiptohen personave që korruptohen ose që korruptojnë. Ajo që është e rëndësishme të bëhet është që secili nga ne t'a luftojmë dhe t'a paraqesim korrupsionin, të reagojmë ndaj tij në mënyra më të ndryshme, të mos heshtim dhe të mos frikësohemi, por bashkë me ne të nxitim edhe të tjerët të lajmërojnë për korrupsion sepse në këtë luftë kundër korrupsionit n'a duhet të jemi të gjithë së bashku dhe njëzëri. Në lidhje me papunësinë si variabla e dytë për të cilën kemi bërë lidhjen e aspektit teorik dhe

praktik, por megjithatë ne mund të themi se ajo paraqet një furnizim të tepërt të fuqisë punëtore. Sipas mendimit tim, ky nivel i lartë i papunësisë është rezultat i menaxhimit të dobët në sferën e arsimit, në të cilin nuk bëhet kategorizimi i nxënësve ose studentëve dhe pastaj ndodh që shumë profesione janë në suficit dhe të tjerat janë në deficit. Ato profesione që janë në suficit, nxjerrin numër të madh të kuadrove dhe si pasojë e kësaj, jo të gjithë punësohen në përputhje me profesionin e tyre dhe kjo çon në rritjen e numrit të të papunëve. Sipas qasjes sime, ajo që është e domosdoshme të bëhet në këtë aspekt, janë reformat thelbësore në sistemin e arsimit të mesëm dhe të lartë. Të mos vijë deri në atë shkallë që disa sektorë të jenë të mbingarkuar e të tjerët të kenë mungesë të kuadrove profesionale. Të merren shembuj nga vendet që kanë nivel të ulët të papunësisë bazuar në analizën e sistemit të tyre të arsimit dhe përvojave të tyre. Është më se e nevojshme që të gjitha mekanizmat institucional të vihen në funksion, në mënyrë që të krijojnë vende të reja të punës që të rinjtë të mund t'i shfrytëzojnë potencialet e veta sepse rrezikojnë që të humbin aftësitë e tyre profesionale dhe në fund të shfrytëzojnë shansin për t'u larguar nga vendi. Për të zgjedhur problemin e papunësisë kërkohet angazhimi i shtetit duke përmirësuar sistemin e arsimit, duke hapur vende të reja të punës dhe duke ofruar ambient afarist të përshtatshëm dhe të sigurtë për të tërhequr investitorë të huaj.

Hapja ekonomike si një variabël që është studiuar në punimin tonë, po ashtu paraqet një problem me të cilin përballen vendet në tranzicion. Vendet në tranzicion siç është rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor që i kemi marrë për studim, kanë deficit tregtar dhe për këtë shkak ekonomia e këtyre vendeve është në këtë pozitë të padëshiruar sepse prodhimi është shtylla kryesore e një ekonomie, ndërsa importi është shenjë e dobësisë së saj. Këto vende e kanë të shprehur importin me çka lejojnë që paratë të dalin nga vendi e jo të investohen në vend. Madje edhe remitancat nuk shfrytëzohen për qëllime investime, por ato harxhohen vetëm për konsum, gjë e cila nuk i ndihmon ekonomisë së vendit që të rritet. Që të zvogëlohet deficit tregtar, është e domosdoshme të rinegociohen marrëveshjet tregtare me qëllim që të pengohet importi dhe të stimulohet eksporti. Integrimi në Bashkimin Evropian edhe pse është një proces i ndërlikuar dhe që kërkon shumë angazhim nga shteti, është një mundësi e përkryer për të shfrytëzuar shansin për liberalizim tregtar për vendet si Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria

që pretendojnë të bëhen anëtare e Bashkimit Evropian. Me anë të kësaj, rritja dhe zhvillimi i liberalizimit do të mundësojë që të tërhiqen më tepër teknologji të reja me çka do të rritet produktiviteti i punës, do të përmirësohet konkurrenca e firmave lokale, do të ulet niveli i papunësisë dhe me fjalë të tjera, do të përmirësohet standardi jetësor. Veçanërisht, vendet me varfëri të theksuar, janë ata të cilat përfitojnë më së shumti nga hapja ekonomike ose liberalizimi ekonomike. Sipas mendimit tim, ajo që duhet të ndërmerret në vazhdim është që rajoni të bëjë përpjekje për shmangie të barrierave tarifore, përmirësimin e klimës për investime të huaja dhe në të njëjtën kohë përmirësimin e kushteve dhe marrëveshjeve për eksport me vende të ndryshme, me qëllim që të pengojmë importin dhe të nxisim eksportin, ose të paktën të arrijmë në atë nivel që të kemi balance tregtar.

Këto dhe shumë rekomandime dhe reforma të tjera thelbësore janë të nevojshme për përmirësimin e standardit të jetesës ose për një rritje ekonomike më të theksuar, gjithmonë duke patur parasysh që të intervenohet në aspektet të cilat ishin objekt studimi i këtij hulumtimi, si për shembull të luftohet dhe të kontrollohet korrupsioni, të ulet niveli i papunësisë me mekanizma të ndryshëm me qëllim që të nxitet punësimi dhe në fund të krijohen kushte të përshtatshme për nxitjen e eksportit ose zhvillimin e hapjes ekonomike.

Ajo që ngelet si hapësirë për hulumtim të mëtejshëm është fakti se ky punim si çdo punim tjetër, nuk mund të përfshijë secilën variabël të mundshme, por që le hapësirë, mundësi dhe dëshirë që disa variabla tjera të rëndësishme si për shembull inflacioni, rritja e investimeve të kapitalit, investimet e huaja direkte, punësimi si dhe variabla tjera me relevancë, të studiohen dhe të inkuadrohen në hulumtimet e ardhshme.

REFERENCAT

1. Nick Hanley, Jason F. Shogren, Ben White, *Introduction to Environmental Economics*, 2001, f. 122.
2. Gary M. Walton; Frank C. Wykoff, *Understanding Economic Today*, sixth edition, f. 235.
3. Natalja von Westernhagen, *Systemic Transformation Trade and Economic Growth*, Developments, Theoretical Analysis and Empirical Results, f. 10.
4. Vasilika Kota, "DETERMINANTS OF ECONOMIC GROWTH IN ALBANIA", 2009.
5. Western Balkans Regular Economic Report No. 14.
6. The Republic of Macedonia, the first country from the West Balkan's region that in April 2001 signed the Stabilization and Association Agreement (SAA) with the European Union, which entered force on 1 April 2004. The Republic of Macedonia applied for EU membership.
7. Zuzana Murgasova, Nedeem Ilahi, Jacques Miniane, Alasdair Scott, Ivanna Vladkova-Hollar and IMF Staff Team, *Regional Economic Issues*, Special Report, The Western Balkans 15 Years of Economic Transition, f. 16.
8. Western Balkans Regular Economic Report No. 14.
9. Data referring to bribery by individuals and households are taken from the recent UNODC study, *Corruption in the Western Balkans: bribery as experienced by the population* (2011).
10. Banka Botërore, GDP per capita (current US), qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD/countries>.
11. UNODC (United Nations Office on Drugs and Crime), *Business, Corruption and Crime in the Western Balkans*, 2013, fq. 8-9.
12. Data referring to bribery by individuals and households are taken from the recent UNODC study, *Corruption in the Western Balkans: bribery as experienced by the population* (2011).

13. <https://www.transparency.org/cpi2017>
14. UNODC (United Nations Office on Drugs and Crime), *Business, Corruption and Crime in the Western Balkans*, 2003, fq. 14-15.
15. Ken Heather, *Understanding Economics*, Third Edition, 2000, f. 253.
16. Gary M. Walton; Frank C. Wykoff, *Understanding Economic Today*, sixth edition, f. 238.
17. Tomasz Mickiewicz and Janice Bell, *Unemployment in Transition*, Restructing and Labour Markets in Central Europe, harwood academic publishers, 2013, f. 11.
18. Banka Botërore, Unemployment, total (% of total labor force), qershor 2015, <http://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS>.
19. Heckelman Jac C. (2000). *Economic Freedom and Economic Growth: A Short-Run Causal Investigation*, Journal of Applied Economics. 3: 71–91.
20. Tomasz Mickiewicz and Janice Bell, *Unemployment in Transition*, Restructing and Labour Markets in Central Europe, harwood academic publishers, 2013, f. 12.
21. PhD student, Department of Political Economics Doctorals School of Faculty of Economic and Business Administration “Alexandru Ioan Cuza” University, Iasi, f. 243.
22. PhD student, Department of Political Economics Doctorals School of Faculty of Economic and Business Administration “Alexandru Ioan Cuza” University, Iasi, f. 244.
23. Chandana Ghosh, Ambar Nath Ghosh, *Keynesian Macroeconomics Beyond the IS-LM Model*, 2019, f. 166.
24. Michael P. Todaro, Stephen C. Smith, *Pembangunan Ekonomi*, 2006.
25. Ken Heather, *Understanding Economics*, Third Edition, 2000, f. 256.
26. Davies, A.; Lahiri, K. (1995). "A New Framework for Testing Rationality and Measuring Aggregate Shocks Using Panel Data". Journal of Econometrics 68 (1): 205–227. doi:10.1016/0304-4076(94)01649-K.
27. Cancado, P.L. (2005), 'Economic Growth: Panel Data Evidence from Latin America', Center for International Studies, f.19.
28. A. Colin Cameron, Pravin K. Trivedi, *Microeconometrics-Methods and Applications*, f. 702.

29. Cancado, P.L. (2005), "Economic Growth: Panel Data Evidence from Latin America", Center for International Studies, f.25.
30. UCLA Resources <http://www.ats.ucla.edu/stat/>
31. Paul D. Allison, Fixed Effects Regression Models, Quantitative Applications in the Social Sciences.
32. Beyond "Fixed Versus Random Effects": A framework for improving substantive and statistical analysis of panel, time-series cross-sectional, and multilevel data" / Brandom Bartels <http://polmeth.wustl.edu/retrieve.php?id=838>
33. B.H. Baltagi et al. / *Economics Letters* 79 (2003) 361–369.
34. A. Colin Cameron, Pravin K. Trivedi, *Microeconometrics-Methods and Applications*, f. 273.

Appendix. A

Tabela A1. Vendet e përfshira në modelin empirik.

Nr.	Vendet e analizuara
1	Shqipëria
2	Serbia
3	Maqedonia e Veriut
4	Bosna dhe Hercegovina
5	Mali i Zi
6	Kroacia

Tabela A2: Përshkrimi i Variablave

Nr.	Variablat:	Detaje:	Kodi:
1	Rritja Ekonomike	Rritja Ekonomike, PBB-ja për kokë banori	Gdp/Pc
2	Korrupsioni	Indeksi i faktorëve insitucional (korrupsioni)	cpia
3	Papunësia	Shkalla e papunësisë	unpl
4	Hapja ekonomike	Indeksi i hapjes ekonomike	efi

Appendix B

OLS

```
. regress gdp corrup unpl efi
```

Source	SS	df	MS			
Model	475.189632	3	158.396544	Number of obs =	69	
Residual	1300.78142	65	20.0120218	F(3, 65) =	7.92	
Total	1775.97105	68	26.1172213	Prob > F =	0.0001	
				R-squared =	0.2676	
				Adj R-squared =	0.2338	
				Root MSE =	4.4735	

gdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
corrup	-3.184644	1.126973	-2.83	0.006	-5.435364	-.9339248
unpl	-.1201261	.0304632	-3.94	0.000	-.1809653	-.0592869
efi	.1352506	.1234703	1.10	0.277	-.1113366	.3818378
_cons	9.621041	7.296304	1.32	0.192	-4.950683	24.19277

Fixed effect

```
. xtreg gdp gdplagl efi unpl corrup, fe
```

```
Fixed-effects (within) regression
Group variable: code

R-sq:  within = 0.0398
        between = 0.4782
        overall = 0.1182

Number of obs = 69
Number of groups = 6
Obs per group: min = 6
                avg = 11.5
                max = 18

F(4,59) = 0.61
Prob > F = 0.6557

corr(u_i, Xb) = -0.8856
```

gdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
gdplag1	.024865	.1255908	0.20	0.844	-.2264416	.2761716
efi	.1031101	.1893003	0.54	0.588	-.275679	.4818992
unpl	.2310115	.1960495	1.18	0.243	-.1612826	.6233056
corup	-1.564961	1.852683	-0.84	0.402	-5.272172	2.142249
_cons	-2.934149	10.70829	-0.27	0.785	-24.36139	18.4931
sigma_u	9.7596451					
sigma_e	3.8000828					
rho	.8683521	(fraction of variance due to u_i)				

F test that all u_i=0: F(5, 59) = 4.01 Prob > F = 0.0034

Random effect

```
. xtset code vitet, yearly
      panel variable: code (strongly balanced)
      time variable: vitet, 1996 to 2014
      delta: 1 year

. xtreg gdp gdplag1 efi unpl corup, re

Random-effects GLS regression              Number of obs   =        69
Group variable: code                      Number of groups =         6

R-sq:  within = 0.0036                    Obs per group:  min =         6
      between = 0.8765                      avg =        11.5
      overall  = 0.3574                      max =         18

Wald chi2(4) =        35.60
corr(u_i, X) = 0 (assumed)                Prob > chi2     =        0.0000
```

gdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
gdplag1	.3376322	.1128514	2.99	0.003	.1164475	.5588169
efi	.099118	.1171717	0.85	0.398	-.1305343	.3287702
unpl	-.0797466	.0317651	-2.51	0.012	-.1420049	-.0174882
corup	-2.010984	1.133812	-1.77	0.076	-4.233216	.2112476
_cons	5.416815	7.029115	0.77	0.441	-8.359997	19.19363
sigma_u	0					
sigma_e	3.8000828					
rho	0	(fraction of variance due to u_i)				

Husman_Taylor

```
. xhtaylor gdp gdplagi corrup unpl efi code, endog( efi corrup)
```

```
Hausman-Taylor estimation      Number of obs      =      69
Group variable: code          Number of groups   =       6

                                Obs per group: min =       6
                                avg =      11.5
                                max =      18

Random effects u_i ~ i.i.d.    Wald chi2(5)       =       1.43
                                Prob > chi2         =      0.9215
```

gdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
TVexogenous						
gdplagi	.0473408	.1239424	0.38	0.702	-.1955818	.2902635
unpl	-.0283517	.1185484	-0.24	0.811	-.2607022	.2039989
TVendogenous						
efi	.0552029	.1803169	0.31	0.759	-.2982116	.4086175
corrup	-1.659988	1.805491	-0.92	0.358	-5.198685	1.87871
TIexogenous						
code	.1616847	1.966927	0.08	0.934	-3.693422	4.016791
_cons	6.183284	10.47596	0.59	0.555	-14.34923	26.7158
sigma_u	7.0268315					
sigma_e	3.677467					
rho	.78499623	(fraction of variance due to u_i)				

Note: TV refers to time varying; TI refers to time invariant.